

FETAVATË E SHAËRAVIJUT

PJESA E TETË

VIII

**Përktheu: Dr.Musli Verbani
Imam i QIKSHN-së**

Oslo, 2010

HYRJE

Falënderimet i takojnë Allahut, Zotit të të gjithë botëve. Zotit të Madh dhe të gjithë madhështive. Përshëndetjet qofshin për zotërinë tonë Muhamedin s.a.v.s., i cili është vulë e të dërguarve dhe peygamberëve dhe po ashtu ndërmjetësues në ditën e Tubimit dhe të Gjykimit.

Falënderojmë Allahun, i Cili e ka mbajtur premtimin duke na e bërë tokën që të jetojmë në të me të gjitha të mirat. Nuk ka Zot tjetër pos Zotit Një, të vetëm. Nuk ka fare fuqi që mund të ndryshojë diçka pos Allahut të Madh të Lartë. Prej atij kërkojmë ndihmë, mbrojtje dhe sigurim.

O Zoti ynë nga Ti kërkojmë mbrojtje prej pasanikut të keq, dhe të varfrit të poshtër. O Zoti ynë nga Ti kërkojmë mbështetje që të mos harrojmë e të biem në grackat e shkatërrimit, mos lejo që të flasim e të mos veprojmë. Punët tona vulosi me të mira. Mos lejo që veprat e këqija të na afrohen gjatë jetës dhe para përfundimit të jetës.

O Zoti ynë shpresojmë në lutjet tona, lutjen e të dobët, të cilin nuk e kthen duar thatë, dhe lutjen e të dëmtuarit, të cilit iu është bërë padrejtësi.

O Zoti ynë nëse shkojnë të mirët na dërgo pas tyre.

O Zoti ynë, na jep për këtë botë pasuri, e për botën devotshmëri, na pajis me punë të mira dhe na mundëso që të arrijmë grada të larta.

O Zoti ynë mëshiroje nënën tonë, bërë banore të xhenetit dhe të përjetojë të gjitha të mirat në të. O Zoti ynë mëshiroji të vdekurit dhe të gjallët tanë, sepse ata kanë nevojë për faljen dhe mëshirën tënde, sepse askush nuk mund të hyjë në xhenet për shkak të veprave të tij, por me ndihmën tënde, ndërsa mëshira jote përfshin çdo gjë.

O Zoti ynë mos na largo prej mëshirës Tënde, sepse Ti je i Mëshirshmi i të gjithë mëshiruesve. E pastë përshëndet Allahu zotërinë tonë - Muhamedin a.s., familjen e tij dhe të gjithë shokët e tij.

Sejid Xhemilë,
Rexhep, 1402,
Maj, 1982, KAJRO.

NJERËZIT JANË THESAR

A janë njerëzit thesare siç po pretendohet?

Po njerëzit janë thesare. Të vërtetën e ka thënë poeti i njohur Ahmed Shevki: Njerëzit janë dy llojesh:

Citoj vargjet e tij Zoti e mëshiroftë:

*Njerëzit janë dy llojesh, të vdekurit mbi dhe të cilët po jetojnë
dhe të tjerët nën dhe të gjallë.*

Nëse e bëjmë një analizë të njerëzve në fytyrë të tokës shohim se ata janë dy llojesh :

1. Njerëzit e mençur të cilët mundën të binden me fakte e argumente
2. Njerëzit injorant ,të cilët janë zhytur në injorancë të cilët nuk binden dhe nuk i pranojnë argumentet por i kundërshtojnë dhe tregojnë kryelartësi ,dhe paraqiten të padrejtë .I nderuari ynë Muhamed Muteveli SHAëraviju na e vërteton neve se nëse Allahu dëshiron që një parim prej parimeve me udhëheq atëherë e drejta patjetër duhet ta ketë fuqinë e argumenteve për ti bind të tjerët ,dhe për ti gjunjëzuar të tjerët me mprehtësinë e gjuhës.

SHOQËRIA IDEALE

Pyetje :Cila është shoqëria ideale,për të cilën me të madhe po flitet?

Përgjigjja:Shoqëria ideale është ajo shoqëria e cila i plotëson të gjitha kushtet e jetesës,të të gjitha nevojave dhe të të gjitha fushave. Arrihet atëherë kur njeriu kërkon shërim,i sigurohet shëndetësia,kërkon punimin e tokës i plotësohen mjetet për ta punuar .kërkon investime për zhvillim ,i epen investime ,po ashtu kërkon mjete për hulumtim i plotësohen kushtet dhe ndahen mjete për atë qëllim. Mirëpo po e zëmë se e gjitha kjo është arritur , pas kësaj paraqiten trazira në ndonjë vend tjetër asaj shoqërie i mungon idealizmi ,atëherë duhet shikuar formë tjetër për të siguruar atë ekuilibër , për tu arrit siguria në brendi të asaj shoqërie ,dhe për t'u arrit siguria nga frika se nga jashtë nuk mund t'ua prish ndokush rendin dhe qetësinë.

KONTRATA PROFITABLE

Blerës është Allahu,shitës janë shpirtrat e besimtarëve,shpërblimi(mjet i pagesës) xheneti. Qëllimi kryesor i njeriut është që të jetojë i lumtur dhe i qetë .Sado që të jetë i shtrenjtë xheneti duhet arritur sa më shpejtë ,ashtu siç e ka shpejtuar sahabiu i njohur i cili i ka thënë të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.,,A është e vërtetë se mes meje dhe xhenetit është vetëm një çështje e ajo është shkuarja ime në front të luftoj pabesimtarët e të me vrasin. Iu është përgjigjur: Po gjithsesi!

Ai i kishte në gojë hurmat ,e nuk ka dashur të jetë gjallë e ti hajë ato hurma por i ka nxjerrë prej goje dhe shkon në front e vritet.

Po ashtu përsosmëria e kontratës dhe fuqizimin e saj e bën arsyetimi në Islam për të shkuar në Xhihad vullnetar.

Amër Ibn Xhunuhe ka pas arsyetim për të mos shkuar në luftë sepse ka qenë i çalë , e u thotë djemve të vet:Patjetër duhet të bie shehid në këtë betejë. I thonë:O baba ynë ,mjafton që ne jemi duke shkuar në këtë betejë,e ai u thotë:Jo,nuk mjafton ,unë patjetër në këtë betejë dua të bie shehid . Djemtë kanë tentuar për ta penguar. E ai shkon te i

Dërguari i Allahut s.a.v.s. dhe i thotë: O i Dërguari i Allahut djemtë po më pengojnë për të shkuar në luftë .E Muhamedi s.a.v.s. i thotë: „Allahu të arsyeton ,nëse nuk shkon "pse i verbëri, i çali dhe sakati nuk kanë mëkat nëse nuk shkojnë në luftë(sepse kanë arsytim) Amr Ibn Xhunuhe i thotë:Për ZOTIN O i Dërguari i Allahut ,Unë kamë dëshirë që të shkeli ne xhenet me këtë këmbë të çalë. I Dërguari i Allahut s.a.v.s. buzëqesh dhe kërkon prej djemve të tij ta lejojnë me shkuar në luftë , edhe pse ka pasur arsytim prej Allahut dhe me sheriatin Islam , mirëpo përkundër kësaj ai e ka pëlqyer kontratën profitabile dhe ka dashur të fitoj.

Ah. po çfarë kontrate !Ai ashtu kështu do të vdes,vdekjes nuk mund ti ik askush. E pse mos me dhënë jetën me çmim të shtrenjtë ,pse mos me dhënë jetën me kontratë profitabile , e cila para njerëzve duket i vdekur ,ndërsa ai është i gjallë dhe furnizohet deri në ditën e kjametit!

Po sa janë të mençur ata?Ata vendosin në peshojë kontratat .I kanë të gjitha të mirat dhe bukuritë e kësaj bote përderisa besimtari jeton ne frymën fetare dhe atëherë kur ta vërtetoj se lidhja e kontratës është me ZOTIN e tij të cilit i beson dhe i Cili e realizon premtimin ,ai i cili e lidh atë kontratë ,e ai s'ka çka me tubuar më të mira ,ai është i sigurt se do të vdes ,mori pjesë në luftë apo jo.

XHENIALITETI I MUHAMEDIT

Profesori Abas Akadi ka shkruar një seri librash për xhenialitetin për të bë analizë rreth personaliteteve Islame me famë si në aspektin filozofik ,shpirtërorë edukativ e shkencorë,prej atyre librave ka paraqitë xhenialitetin e Muhamedit s.a.v.s. xhenialitetin e Ebu Bekri Sidikhit , xhenialitetin e Omerit ,xhenialitetin e Halid bin Vehidit etj.

Çka mendon Shejh Shaëravuju në lidhje me këtë .

I nderuari Imam thotë: Deri sa rahmetliu Profesor Abas Mahmud Akadi ka shkruar librat serik të „xhenive" Allahu e di dhe Ai është dëshmitarë se kam shkruar dhe kam thënë : Nëse lejohet që për ndonjë sahabe me thënë xheni (xhenialiteti i Ebu Bekri Sidihit,,ose xhenialiteti i Omerit) kjo nuk lejohet të thuhet për të Dërguarin e Allahut s.a.v.s (xhenialiteti i Muhamedit) . Sepse Muhamedi s.a.v.s. nuk ka pasur asgjë të përbashkët me xhenialitet në lidhje me procesin (misionin) e tij. Për këtë arsye edhe Zoti i Lartmadhëruar ka dëshmuar analfabetizmin e tij. dhe vetë dëshmia e analfabetizmit të tij e absorbon mendimin se ai nuk ka qenë analfabet dhe se ka pasur ndonjë epitete prej epiteteve njerëzore. Allahu ka dashur të jet ashtu,pra nuk i ka lejuar epitete prej epiteteve njerëzore,por çdo gjë që ka poseduar ai nuk ka qenë prej epiteteve njerëzorë por epitete qiellor.

Që do të thotë Ai,Allahu është i Cili e ngriti çështjen dhe epitetin e tij shkencorë. Është e vërtetë se njerëzit kur të dëgjojnë fjalën analfabet e marrin si mangësi ,por e vërteta nuk është ashtu. Analfabetizmi në mua nuk nënkupton mangësinë time, ndërsa analfabetizmi në Muhamedin s.a.v.s nënkupton përsosmëri. Sepse çdo gjë i ka ardhur prej Zotit të vet. Ndërsa nëse e them këtë (xhenialitet) e kam zhvlerësuar vlerën e burimit.

E pas kësaj ka thënë: Ka popull analfabet sepse populli është ai i cili e bartë mesazhin , e bartë sistemin legjislativ ,e pastaj e këshillon botën ,e bota (popujt tjerë) mahniten me fjalë tjera. Kjo nuk është shkallë e civilizimit ,sepse populli analfabet nuk ka të bëjë me këtë. E kur të behet pyetja :Prej nga ka ardhur e gjithë kjo. Ne përgjigjemi:prej qiellit/.Por po të kishte qenë në pyetje një epokë e civilizimit ,kjo do t'i kishte ndodhë në epokën e civilizimit Persian ,apo Ramah . Ne do të kishim thënë :Epokë e civilizimit sikurse epokat tjera civilizuuese. Mirëpo kjo ka ndodhë në vendet arabe me popullin analfabet. Për këtë arsye edhe Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:Thuaj:PO të kishte dashur Allahu nuk

do t' kisha lexuar juve dhe nuk do ta kisha pranuar (mësuar) e përcjellë juve. Sepse veç kam jetuar tërë këtë jetën në mesin e juve më parë. A nuk po logjikoni?

JUNUS 16

Përpos kësaj ,kush do të arrinte xhenialitetin tek pas viteve të katërdhjeta, ndërsa ne e dimë se xhenialiteti te njeriu paraqitet në vitet e njëzeta e tridhjeta. A është e mundur që dikush ta ketë në vete xhenialitetin e ta paraqes vetëm pas viteve të katërdhjeta. Thonë: Jo. E ka pasur të lindur xhenialitetin por ka prit ti paraqet pasi ti arrijë pjekurinë pas viteve katërdhjeta. Ne kundërpërgjigjemi:Po kush mund të dijë se unë do të jetojë derisa të më paraqitet kurse njerëzit për ditë vdesin .Ky vdes në kaq vjet e ai në aq vjet. Kush i garanton atij se do ti arrij të katërdhjetat e pastaj ti paraqitet xhenialiteti. Pra xhenialiteti njerëzor është e mundur për njeriun. Por bëhet pyetja pse? Sepse te ai do të kenë ndikim rrethanat dhe njerëzit përreth tij,e pastaj ai ndikon te të tjerët. Kështu thënia e Akadit për sahabet është në rregull ,ndërsa për të Dërguarin e Allahut s.a.v.s nuk është në rregull sepse arsimimi shkencor i tij nuk është prej njeriut por prej lartë,pra prej Zotit.

NË MES TË SHPIRTIT DHE TRUPIT

Qenia njerëzore përbëhet prej dy komponentave, atij shpirtëror dhe truporë. Elementet kimike në trupin e njeriut reflektohen vetëm atëherë kur shpirti është në te,që në çastin kur ndahet prej tij aktiviteti i tij paralizohet në tërësi.

Të fjeturit nuk i shkruhen mëkatet deri sa të zgjohet,sepse shpirti në atë çast është i ndamë prej trupit, dhe konsiderohet sikurse mos me pas qenë fare. A mendimi me thënë se: Shpirti dhe trupi së bashku kanë përgjegjësi të plotë për mëkat si përgjegjësi e tyre ndaj dëgjueshmërisë së krijuesit të Lartmadhëruar. Çka mendoni në lidhje me këtë:

Përgjigjja: Imami i nderuar Shejh SHAëraviju thotë: Materia e tërë ekzistencës është materie e vullnetit , tesbihut dhe adhurimit .Për këtë arsye që në momentin kur të mungon dëshira e dëshiruesit nga materia, atëherë materia kthehet në natyrshmërinë e saj.

“Atë ditë kur kundër tyre do të dëshmojnë gjuhët e tyre ,duart e tyre dhe këmbët e tyre për atë që kanë vepruar”.

*EN-
NURË 24*

Sepse atëherë nuk do të ketë askush pushtet mbi ta ,por pushtet mbi te ka Allahu ndërsa më herët ti ke pas pushtet mbi pjesët e tua ,dhe pjesët e trupit nuk mundën me të kundërshtuar, sepse ke pushtet të drejtpërdrejtë mbi ta,ndërsa në ditën e kijametit nuk do të kesh pushtet mbi pjesët e trupit ,për këtë arsye edhe dëshmojnë kundër teje.

Materia e trupit të pabesimtarit është e gjykuar me madhëruar Allahun, sepse dëshira e pabesimtarit nuk ka ndikim në te ,por edhe pse ai nuk e madhëron e madhëron materia e tij. Reflektimi i dëshirës pabesimtarit është pabesimi i tij,mirëpo materia e tij i nënshtrohet dhe madhëron Zotin e Lartmadhëruar.

Mos thuaj shpirtëror dhe materiale. Kjo thënie e cekët sipërfaqësore ,e nuk është term shkencorë. Gjërat për nga natyrshmëria e ekzistimit të tyre janë adhuruese dhe madhëruese te Allahu. Për këtë arsye as mos cilëso vetëm materien,mos e cilëso vetëm shpirti,por bëhet fjalë për „NEFSIN" e kuptimi i „NEFSIT" është se shpirti është i ngritur për materien e pastaj vjen vullneti dhe çështjet tjera ,e tek pastaj ndodhin çrregullimet.

MOS TA KTHEFTË ALLAHU TË HUMBURËN

Pyetje: Kur një njeri ka shkuar ne xhami dhe e ka kërkuar një send të humbur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. i ka thënë „Mos ta ktheftë Allahu".Pse i ka thënë kështu?

Shejh Shaëravij përgjigjet: Sepse xhamia është një vend ku njeriu(vizitori) duhet të dijë se nuk duhet ti shkoj mendja askund tjetër pos që ai është drejtpërsëdrejti me Allahun e Lartmadhëruar.

Pasi xhamia është destinuar për këtë adhurim,atëherë kjo nënkupton se në të nuk ka çka të zhvillohet ndonjë aktivitet tjetër të jetës,pse namazi është adhurim. Vërtetë xhamia është vendi të cilin robi e ka emëruar për Allahun dhe çdo akt tjetër të cilën e kryejnë njerëzit në shtëpinë e Allahut ,patjetër duhet të jetë gjykuar që ajo kontratë me dështuar.

Për këtë arsye besimtari që në momentin kur hynë në xhami le ta bëjë nijet se është duke bërë iëtikaf se do të qëndroj në xhami ,sepse njeriu nëse flet për çështje e cila nuk ka të bëjë me Allahun le ta dijë se ai për atë çështje nuk do të ketë sukses. Disa njerëz e kanë bërë traditë që në xhami ti bëjnë takimet e kontratave në shitblerje ,apo takime për interesa të dynjasë,ndërsa ata harrojnë se xhamia e ka rolin vetëm për ibadet dhe përfitim të diturisë ,por ata duhet ta dinë se çdo kontratë apo çdo aktivitet prej aktiviteteve të kësaj bote i cili zhvillohet apo kontraktohet është e pabereqetshme.

Pyetje: Cila është arsyeja e mekruhrit të tregtisë në xhami?

Imami i nderuar përgjigjet: Sepse kur çështjet (interesat) e dynjasë hynë te njeriu ,fillojnë grindjet,kacafytjet e mospajtimet engriten zërat etj. etj. gjë që ndikon që çdo njeri të ndiej veten të nënçmuar e të turpëruar ashtu me taku Allahun dhe me qëndruar para tij.

Imami i mirënjohur pastaj thotë:Në xhami takimi i vëllezërve besimtarë duhet të jetë takim i afrimit dhe dashurisë mes vete e jo takim i konfliktit.

Në xhami takimi me Allahun duhet te prodhoj qetësi të zemrës e jo me qenë qëndrim për përfitim të dynjasë ,sepse aty jemi në praninë e Bamirësit të Përgjithshëm.

-Çka mendon për përcaktim të gjithëshëm në një vend të xhamisë , pse Allahu e ka ndalu atë.

Përgjigjja: Disa njerëz shkojnë në xhami dhe ulen gjithmonë në një vend ,ndërsa ata harrojnë se Pejgamberi s.a.v.s e ka ndalu që gjithmonë me u ulë në një vend .E kjo do të thotë se kjo është haram duke shkelur nëpër krahë të xhematit për të arritur të vendi i caktuar i tij.

-A është e vërtetë se rreshti i parë ka vlerë më të madhe se rreshti i dytë ,dhe rreshtave tjerë?

Përgjigjja:Çdo vendqëndrim (radhitje) në xhami konsiderohet ,ajo renditje e cila është më herët se thirrja e Allahut disa mendojnë se rreshti i parë ka shpërblim më të madh se rreshti i fundit,jo kjo nuk është e vërtetë , sepse është e palogjikshme që njeriu me ardhur pas thirrjes së ezanit të shkeli xhematin ti ngushtoj ato për me arritur te rreshti i parë ,rreshtat dhe renditjen e bën Allahu e jo ne.

Njeriu duhet ta pyes veten e tij ,si të hyjë në shtëpinë e Zotit tim kështu duke shkelë mbi supet e tjerëve. Besimtari duhet që të ulet në çdo vend të xhamisë pa ngushtuar askënd , sepse qëllimi i hyrjes në xhami është që ta heqë egoizmin prej vetes së tij dhe përfitimit të kësaj bote ,dhe plotësisht ta përfitoj dashurinë e Allahut ,dhe se hyrja dhe qëndrimi në xhami është përforsim i imanit , pastrim dhe shkëlqim i shpirtit me rreze të reja drite..Po edhe nëse është e vërtetë teksti,pra alegoria e vërtetë ne prapë themi: Bateritë e zemrës mbushen me dritën , shkëlqimin dhe prezencën para të gjithëmëshirshmit dhe në moment kur ti mbush bateritë e tij me dritën e të Gjithëmëshirshmi, njeriu duhet të dalë prej xhamie për me vazhduar jetën dhe aktivitetin e tij ,pasi që në xhami ka përforsuar imanin

, devotshmërinë mirësinë dhe kënaqësinë e të Gjithëmëshirshmit.

DHJETË DITËT E FUNDIT TË RAMAZANIT

Cila është urtësia (arsyeja) e qëndrimit të dhjetë ditëve të ramazanit në xhami(i cili është sunet)

Përgjigjja: Qëllimi është ngritja dhe lartësimi i ngarkimit me obligime me qëllime që muslimani të pastrohet plotësisht sepse në rend të parë vetë agjërimi, është ushtrim dhe trajnimi i njeriut për me ia ndalu vetës sendet e lejuara ,dhe iëtikafi me dhjetë ditët e fundit të Ramazanit është sunet ,po ashtu muslimani ka të drejtë të qëndrojë në xhami ose në shtëpi .E kur njeriu zgjedh që të largohet prej vendit dhe familjes së tij,kjo nga arsyeja që njeriu ti ndaj disa dit vetëm për Allahun, me shkuar dhe me qëndruar në xhami dhjetë ditë dhe të pastrohet e të ndriçohet me dritën e cila depërton thellë pasi njeriu veç e ka lënë familjen e tij,pasurin e tij,e në atë trajnim apo ushtrim është udhëtimi tjetër pra ,plotësimi i ruknit të pestë të Islamit , haxhi. Sepse në atë ditë udhëtimi i njeriu lenë familjen e tij,vendin e tij ,pasurin e tij dhe synon shtëpinë e Allahut.

Kështu ietikafi bëhet ushtrim i devotshmërisë dhe përgatitje për të shkuar në Qabe ,në të cilën çdo musliman shkon me zemër dhe e forcon bindjen në zemrën e tij ,ashtu fortë sikurse është duke e pa drejtpërsëdrejti.

GJËRAT E NËNSHTRUARA PËR NJERIUN

Zoti i Lartmadhëruar thotë: Dhe ne e kemi krijuar njeriun dhe ia kemi bënë shtrojë (në shërbim të tij) çka në tokë e në ne det. Po ashtu ka thënë:„Ka krijuar çka ka gjithçka në tokë për të gjithë juve" Njeriu në këtë gjithësi është epiqendra , Zoti i Lartmadhëruar ia ka nënshtuar çka ka në tokë e çka ka në det ku Zoti i Lartmadhëruar thotë: Ai është i cili ka bërë tokën shtrojë të dobishme dhe të përshtatshme andaj ecni nëpër te dhe ushqehuni prej furnizimeve të saj" Në thënien e Zotit të Lartmadhëruar „për ju" dhe thënies „të përshtatshme" tregohet qartë se sa janë të nënshtuara krijesat prej Allahut për krijesën njeri. Parashtrohet pyetja: Pse Allahu i Lartmadhëruar të gjitha këto çështje i ka nënshtuar për njeriun?

Shejh Shaëraviju përgjigjet: Vërejmë se Zoti i Lartmadhëruar ka thënë„ka krijuar për ju" pra të gjithë njerëzit e jo vetëm për besimtarët. Në hadith kudsij Zoti i Lartmadhëruar thotë:„O biri i Ademit ,sendet i kam krijuar për ty,ndërsa ty të kam krijuar për Mu, mos e lodh veten në ato çka jan për ty por angazhohu për atë për çka je ti. Ky hadith Kudsij na shtyn të pyesim : A mundet fuqia dhe aftësia ime t'i shtyj këto krijesa të më shërbejnë mua. Unë nuk kam mundësi të mbizotëroj diellin, hënë,ajrin,ujin , mirëpo ato më shërbejnë mua pa e përdor fuqinë ime mbi ta. Duhet ta analizoj këtë atëherë,për çka është krijuar njeriu?

Zoti i Lartmadhëruar thotë:„Njerëzit dhe xhinët i kam krijuar vetëm e vetëm me më adhuruar"

Zoti i Lartmadhëruar e ka krijuar njeriun për me tregu dhe sqaruar se ai e nënshton të fuqishmin për më të dobëtin. Nuk ia ka nënshtuar njeriut vetëm çështjet të cilat ka mundësi ti mbizotëroj por edhe çështjet të cilat nuk ka mundësi ti mbizotërojë. Kështu shohim se të gjitha fenomenet natyrore nuk kanë të drejtë lirie për të më shërbyer , por ato janë të nënshtuara për të na shërbyer dhe nuk mundet as dielli ,as ajri e as uji me më refuzuar për me më shërbyer , sepse ekzistenca e tyre është parapa për të qenë ashtu.

Zoti i Lartmadhëruar i ka bënë këto sende në shërbim tonin për tu pa fuqia e nënshtimit të

atyre sendeve ndaj neve dhe për tu pa sundimi absolut i Zotit të Lartmadhëruar ndaj krijesave të Tij për ta nënshtruar të fuqishmin ndaj të dobëtit dhe askush nuk mund të ndryshojë diçka në këtë,pastaj njeriut i thotë:Ty ti kam nënshtruar të gjitha në këto çështje ,dhe të gjitha janë në shërbim tëndin ,ndërsa ti duhet të më dëgjosh për shkak të dashurisë tënde ndaj Meje,ndërsa krijesat tjera janë nënshtruara pa vullnetin dhe pa dëshirën e tyre. Mirëpo unë ty në disa çështje të kam dhënë të drejtë zgjedhje .Nëse do më beson dhe më përgjigjesh ,e nëse do mund të mos më përgjigjesh. Atëherë Allahu kërkon nga ne ta duam Atë me dëshirë përderisa ne kemi mundësi ta duam ose jo. Pse ka dallim të madh në mes të nënshtrimit ,imponimit detyrimit dhe dashurisë. Për këtë arsye Zoti i Lartmadhëruar në hadith Kudsij thotë:„O bir i Ademit unë të dua,e detyrë e jotja është që të më duash"Kjo është shkalla më e lartë e edukatës dhe moralit të njeriut.

BOTA E VËSHTËRSIVE

Pyetje:Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Vërtet Ne e krijuam njeriun (të jetojë) në vështirësi të njëpasnjëshme”. (*El-Beled*, 4)

“O njeri, vërtetë ti përpiqesh me një përpjekje të madhe që qon te Zoti yt, e atë (përpjekje) do ta gjesh”. (*El-Inshikak*, 6)

Përgjigjja: Shejh Shaëraviju thotë: Kjo është kështu vetëm për ata që nuk besojnë ndërsa ata të cilët e pranojnë këtë me imanë (besim) në Krijuesin e kësaj bote dhe te tij jo. Të ekzistuarit e lodhjeve ,mundimeve dhe vështirësive është për atë i cili nuk beson në Zotin dhe njëherit është argument për besimin në Zotin dhe vërtetësinë e programit të Allahut. ne i përgjigjemi pyetësit: Allahu nuk e ka bërë këtë botë ,botë të vështirësive , lodhjeve dhe dhembjeve ,por kjo është e tillë për ata të cilët largohen nga programi i Allahut. Për këtë arsye ne shohim se besimtarët janë më të lumturit dhe më të kënaqurit në çdo gjë çka iu është caktuar prej Allahut..Kjo nëse ti ke për qëllim lodhjen e zemrës ,ndërsa nëse e ke për qëllim angazhimin për jetë dhe lodhja për ekzistencë ,kjo është një çështje tjetër. Sepse kërkohet që njeriu të jetë refleksiv me ekzistencën ,nëse ai dëshiron të zhvillohet. Allahu ka krijuar ujin ,mirëpo unë në vend se të shkoj te burimi të pijë ujë e atje të mbushi bidonat për çdo ditë dhe ti plotësoj nevojat e mia ,e mbushi një rezervuar të madh e pastaj e përcjelli deri aty me gypa e prej aty e afrojmë brenda në shtëpi ,dhe kam ujë vazhdimisht e kjo është komoditet të cilën e dëshiron njeriu,mirëpo për të arritur deri aty nevojitet lodhje dhe angazhim .Mirëpo përpos kësaj ka lodhje dhe angazhim të llojit tjetër e cila mundon e ajo është mundimi i zemrës dhe brengosja .Për këtë Kur'ani fisnik thotë:Dhe kush prej juve vjen te unë i udhëzuar e kush pason udhëzimin ,për ta nuk ka brengosje e frigë dhe ata nuk pikëllohen"Në ajetin tjetër thotë:"Dhe kush pason

udhëzimin tim nuk do të humb dhe nuk do të jetë i lodhur e kryeneç. Dhe kush ia kthen shpinën librit (këshillave) tim ai do të jetojë jetë të vështirë
Pyetësi thotë:Vërtet kjo jetë është krijuar për lodhje e vështirësi . ne i themi:Kjo botë është kështu për ata të cilët ia kthejnë shpinën librit të Allahut .Kjo është kështu se i paraqitet mundimi dhe lodhja dhe mundimi ,ndërsa sa i përket besimtarit kur ti paraqitet lodhja ai e di dhe beson se ajo çështje jashtë çështjeve dhe dëshirave të tij ai shpërblehet për durimin që bën dhe praj atij...

DALLIMI MES PROGRAMIT DHE PROGRAMIT

A ka dallim në mes të maksimës „Kur'ani program" dhe maksimës tjetër,„Kitabi program?

-Imami i nderuar Shaëraviju thotë: Kush thotë Kur'ani ka zbritur si libër PROGRAM kjo do të thotë se ai program është i vetmi dhe nuk ka tjetër program dhe nuk tjetër program pos tij. Ndërsa „Libri program" e lejon që përpos tij me pas program tjetër.

Përderisa Kur'ani në të cilin besojmë i ka dhënë të drejtë Pejgamberit s.a.v.s. për ankesë,pra për me ligjësuar diçka, kjo do të thotë se është ligjësuar në Kur'an.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:Çka ju jep (dispozitë) i dërguari pranojeni si vendim e çka ju ndalon ai juve ju largohuni dhe pranojeni si ndalesë".

EL HASHR

7

Kjo dëshmon se ka dispozita të veçanta .Po ashtu edhe ajeti Kur'anor ku Zoti i Lartmadhëruar thotë:

„Por jo, për Zotin tënd!Ata nuk besojnë , përderisa të të bëjnë ty (Muhamed) gjykues për të gjitha mosmarrëveshjet mes tyre ,dhe përderisa nuk mbetet në veten e tyre (mesin e tyre) asnjë pikë kundërshtim ndaj vendimeve tua ,dhe përderisa ti pranojnë plotësisht (ato vendime) të nënshtruara.

EN-NISA65

Kjo sepse i dërguari i Allahut ,çka ka vendim të Allahut në Kur'an e zbaton dhe e vepron ,e çka ka në Kur'an atëherë merr vendim si i autorizuar prej Allahut.(Kur'anit). Pra çka vendos i Dërguari i Allahut s.a.v.s. edhe pse nuk është me tekst të qartë ai vendos si i autorizuar prej tekstit të qartë të Kur'anit.

ABIDËT DHE UBADËT (ROBËRIT DHE TË ROBËRUARIT)

Pyetje: A ka dalim në mes të fjalës ,të gjithë ne jemi “Abidullah” dhe fjalës të gjithë ne jemi “Ibadullah"

Përgjigjja:Imami i njohur thotë: Kur njeriu nuk mëkaton edhe pse ka mundësi atëherë kjo do të thotë sakrifikim për Allah. Ne që të gjithë jemi Abidullah dhe nuk jemi Ibadullah.Ibad jan ata, të cilët nuk kanë por në tërësi janë të nënshtruara zotit të tyre të Lartmadhëruar . Besimtari thotë: Zoti im më ke dhënë vullnet dhe liri të plotë ,por kërkesat tua do të jenë më të larta sa vullneti im. Ndërsa në ditën e kijametit hiqet e drejta e vullnetit dhe lirisë dhe të gjithë bëhemi ABIDUHU „Dhe çdo gjë çka ka në qiej dhe në tokë patjetër do të jenë pranë të Gjithëmëshirshmit ABDA. Ne i kemi numëruar, i kemi llogaritur veç e veç një nga një"Përderisa më herët ata kanë pasur vullnet dhe liri në vetvete ,për këtë arsye ne në tokë kemi sundim mbi veten tonë,mirëpo në ahiret Zoti i Lartmadhëruar thotë:„I Kujt është sundimi sot"saqë edhe trupat tonë nuk na dëgjojnë neve .këtu ,në këtë botë trupat tonë na nënshtrohen neve dhe dëshirës sonë,këmbët shkojnë ku

dëshiroj,duart prekin çka të dëshiroj unë,dhe e prekin kë dëshiroj unë. Ofendoj ,shaj flas çka dëshiroj dhe gjuha nuk më kundërshton. Ndërsa në botën tjetër ato më kundërshtojnë dhe dëshmojnë kundër meje,kundër kohës në të cilën kam pasur liri dhe sundim mbi ta , mirëpo atje ka marrë fund ata jan çliruar në tërësi nga zotërimi im mbi ta.

VETËM PËR MESHKUJT

Pyetje:Pse Allahu i Lartmadhëruar u ka premtuar vetëm meshkujve hyritë e xhenetit e nuk u ka premtuar grave?

Përgjigjja: Imami i mirënjohur thotë:Zoti i Lartmadhëruar i ka parapa të mirat e xhenetit në harmoni me atë çka do zemra e shëndoshë dhe e drejtë. femra për nga natyrshmëria e saj e shëndoshë nuk dëshiron të ketë më shumë se një burrë ,sa që edhe grave të cilave u vdesin burrat , refuzojnë të martohen pas vdekjes se burrave të tyre,edhe pse e drejt e tyre është dhe e kanë të lejuar martesën. Ajo e konsideron si ndershmëri e saj që mos ketë më shumë se një burrë. Ndërsa burri dhe personalitet i burrit është të ketë më shumë se një grua .E i ka dhënë burrit atë çka e vërteton burrinë e tij , ndërsa i ka dhënë gruas ndershmërinë pastërtinë dhe krenarinë. ndoshta femra mund të mendoj se burrit i ka dhënë më shumë se asaj ,por ne themi:Edhe në këtë botë burrit iu është dhënë të drejtë të martohet me më shumë se një grua,ndërsa femrës jo. Në xhenet gruaja nuk do të ndahet nga burri i saj,sepse në xhenet nuk shkojmë me natyrshmërinë tonë ,por ndryshon paralelizmi ,pra natyrshmëria .Zoti i Lartmadhëruar thotë: „Dhe ne do të heqim nga gjokset e tyre çdo pikë hidhërimi dhe inati "Sadakallahu adhijmë.

PËRSËRITJA E UMRES DHE E HAXHIT

Shkuarja në haxh më shumë se një herë e cila shkakton turmë të madhe dhe përsëritja e umres më shumë se një herë janë mekruh. Dhe a është e vërtetë se dhënia sadak e shpenzimit të haxhit ka më shumë shpërblim te Allahu?

Përgjigjja:Argumenti më i madh në lidhje me gabimin në këtë mendim është se shumica e Haxhilerëve jan për së dyti e për së treti,thuaja se haxhi vullnetar nafile nuk mund t'i imponohet që në vend të atij veprimi vullnetar ndonjë punë vullnetare tjetër....kështu ai vepron çka të do ,çka ia do shpirti dhe nuk ka diçka më të vlefshme se ai veprim. Ndërsa s i përket të përsëriturit të umres kjo është në rregull ,sepse Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:„Dhe kush e bën(umren)vullnetarisht (shumë herë) është e dobishme për të.

Disa thonë:Nuk lejohet që të bëhen më shumë se nje UMRE në një vit sepse umreja nuk është si haxhi sepse nuk lejohet të përsëritet ajo çka në nivel më të ulët se ajo çka është në nivel më të lartë,pasi që nuk e përsëriti kryesoren(haxhin) në të njëjtin vit. ne përgjigjemi atyre se haxh është i caktuar dhe përkufizuar në kohë e pasi që është puna kështu nuk mund të përsëritet në ndonjë kohë tjetër , p.sh. Nuk mund të them se do ta kryej haxhin në muajin sheval apo muajin safer, sepse haxhi e ka kohën dhe nuk lejohet në ndonjë

kohë tjetër,ndërsa umreja nuk është e përkufizuar në kohë ,dhe mund ta kryej në çdo kohë , dhe në çdo kohë që më jepet rasti e përsëris haxhin dhe çdo gjë është në rregull.

DHUNTI SPECIFIKE DHE ANGAZHIMI PËR DHUNTI

Shumica e njerëzve të rëndomtë flasin për dëshirën e tyre që të jenë evlija, të cilëve Allahu u shpalos fshehtësinë e Tij, e tu lajmërojnë njerëzve çka ka me ndodh në të ardhmen, çka fshehte në të ardhmen, ata cilësohen evlija të Allahut. Çka mendon Shejh Shaëraviju për këtë.

-Cilët janë evlijatë e Allahut?

Përgjigjja: Imami thotë:Allahu kur ta cakton që një njeri me qenë evlija ose i jep urtësi (fuqi) të drejtpërdrejtë ,ose mundësi që ai ta arrijë me angazhim. Allahun nuk mund ta detyrojë çfarëdo shkak ,dhe te ai nuk mund të arrijë askush pos ai i cili është i dëgjueshëm ndaj Tij .ka njerëz të cilët e arrijnë kerametin e Allahut duke qenë të dëgjueshëm ndaj Tij. Ka njerëz të cilët me kerametin e Allahut arrijnë shkallën e dëgjueshmërisë ndaj Tij .Pra i pari në rend të parë e dëgjon Allahun,e për atë arsye Allahu e ngritë në nivelin e kerametit .E te i dyti në rend të parë Allahu e cakton në nivelin e kerametit e pastaj ai bëhet i dëgjueshëm bdaj Zotit.

Po të ishte që të gjithë çështjet të ishin të varura prej shkaqeve të tyre dhe të gjitha çështjet do të shkonin vetëm në bazë të shkaqeve të tyre. Atëherë njeriu do ta humbte shpresën në mëshirën e Allahut ,dhe Allahu fuqinë e Tij do ta aktivizonte vetëm menjëherë. Mirëpo Allahu e ka përdorë fuqinë e Tij absolute sepse Ai vepron çka të dojë. Zoti i Lartmadhëruar thotë: Ata të ...Padyshim se ata për të cilët ka parapri mirësia nga Ne ,do të jenë të larguar larg prej andej (xhehenemi). Po ashtu Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: „Ata të cilët angazhohen për Ne do ti orientojmë në rrugën Tonë" Asgjë nuk mund ta detyrojë fuqinë e Allahut të Lartmadhëruar .Më të afërtit te Allahu janë ata të cilët me mundimet ,angazhimet dhe aktivitetet e tyre më të mëdha arrijnë në afërsi të Allahut .Sepse ato debatojnë,ligjërojnë me diturinë e tyre ,argumentojnë dhe shihen se janë lartë e pastaj për shkak të diturisë dhe angazhimit të tyre ballafaqohen me sfida të mëdha. Ne e dimë se kur Omeri r.a. u ndal ka bë lutje për shi ,dhe nuk ka ra shi. Duke u kthyer e gjen një rob plak i cili lutet vetëm për ujë,Omeri pastaj ka shkuar te farkëtari (zotëria i tij) dhe i ka kërkuar robër me ble .Mirëpo farkëtari mendon se Omeri dëshiron me ble rob të fuqishëm dhe rob të kategorisë së parë i thotë:O emirë i besimtarëve ,unë nuk kam robër ,gjithçka kam është vetëm një,dhe ia sjell ,kur e sheh se ishte ai Omeri i thotë:Ky është të cilin dua ta blejë. Ai rob e sheh dhe lutet:„O Zoti im ashtu siq e ke bë të shihem para njerëzve më merr pa u sprovuar fare ,dhe në atë qastë vdes.

Pastaj Imami i mirënjohur thotë:Të fshehurit e sekretit është dhunti e madhe të cilën na ka dhuruar Allahu neve ,ndërsa shpalosja apo zbulimi i atij sekreti është humbja e asaj dhuntie. ti lëmë çështjet si janë,le të jetojmë të izoluar për shkak të butësisë me të cilën Allahu dëshiron që të na dhurojë mirësi. Përpos kësaj ,këtu është një çështje e rëndësishme .PO nëse e di të fshehtën ,a mundem me pengu mos me ndodh, natyrisht se jo. Atëherë pse tërë kjo zhurmë,ky mundim i cili më mundon mu. për këtë arsye njeriu çështjet duhet lërë Allahut , përderisa aty nuk mund të ketë qasje. Allahu i ka krijuar këto çështje që të shtojë qetësi ,dhe të na mbjellë bindje, e jo për të na përçarë në mendime e me i lodhë mendjet tona.

SHAËRAVIJU DHE EDUKIMI

Pyetje:Çka do të thotë fjala edukim?

Përgjigjja: Edukim do të thotë se ta përforcojmë besimin në Allahun ,dhe po ashtu ka kuptimin që i edukuari të arrijë në shkallën e përsosmërisë e cila ju ka ofruar atij.

-Cili është burimi i edukimit në Islam?

Edukata Islame burimin e ka në planprogramin e Allahut. Kur edukata Islame të vendos programin në të vërtetë ai ka vendos program për Allahun i cili e ka krijuar njeriun ,Krijuesi i cili e ka krijuar njeriun dhe gjithësinë i cili i di më së miri rregullat dhe ligjet që i nevojiten Atij

Pyetje:Cila është teoria Islame në edukimin fizik?

Islami e parasheh rolin edukativ në atë duke zgjedh llojin mashkullorë dhe femërorë që ato të takohen në një pikë e cila u sjell atyre pasardhës. teoria Islame në edukim bazohet në barazimin thelbësor të të dy gjinive. E barazim në esencë kemi për qëllim barazimin psikik , shëndetësor ,fizik dhe moral. Imami i mirënjohur thotë:Islami këtë çështje e parashtron para se të lind fëmija apo para se të fillon edukimi i fëmijës sepse Islami dëshiron që ti siguroj fëmijës ambient të përshtatshëm në vendin ku fillojnë qelizat e para të tij. Përpos kësaj në këtë kohë i është dhënë e drejta e trashëgimisë varësisht prej gjinisë po ashtu edhe prej llojit familjar(prindor) sepse aty fillojnë cilësitë të cilat cilësi do të jenë bazë për edukimin e mëtutjeshëm.

Pyetje:Cila martesë është harmonike ,me të afërmit apo me të largët?

Imam Shaëraviju tregon se Islami insiston në martesën e qifteve që të jenë sa ma të largët ,që të mos lind dhe zhvillohet fëmija i dobët dhe me të meta. Pastaj Imami në lidhje me këtë thotë:Kur Kur'ani dha sunetin na orienton në këtë parim ,ai e ka vërejtur pikën e parë të edukimit që fëmija të rritet me dhuntitë e Allahut , fëmijë i fuqishëm me të gjitha cilësitë pozitive sepse nuk mund të tubohen cilësitë pozitive prej një fare apo një lloji (farefisnor).Imami potencon të drejtën e fëmijës që atij ti epet qumësht prej nënës dy vite të plota ,e pasi që familja ta kalon fazën e gjirit e fillon në fazën e përkujdesjes. I epet përkujdesje e fëmijës e atij i cili është i përshtatshëm për organizmin e tij.

E kjo e drejtë është e nënës .Këtë Imami e arsyeton me thënien e tij „Sepse fëmija në vegjëli nuk ka nevojë për njeri tepër të mençur ,por ka nevojë për butësi , ledhatim e ngrohtësi të cilat veçori i ka natyrshmëria e nënës.

Pyetje:Cilat janë shkaqet e çrregullimit psikik te fëmijët të cilat janë çrregullime të shumta?

Përgjigjja: Imami i nderuar përgjigjet:Prej shkaqeve kryesore të presionit psikik te edukimi i fëmijëve ,është dallimi në mes tij. Kur njërit i epet më shumë e tjetrit më pak , njërit i kushtohet përkujdesje më e madhe e tjetrit jo ku në ato momente fëmija ndien se nuk është njeri i barabartë me të tjerët. PO ashtu shkak tjetër është se njeriu gjithmonë kërkon shumë e më shumë .Zoti i Lartmadhëruar thotë për vëllezërit e Jusufut, Dhe kur thanë: Jusufi dhe vëllai i tij janë më të dashur se ne ta baba i ynë ndërsa ne jemi shumë . Nuk ka dyshim se baba ynë është në humbje të qartë"

JUSUF 8

Pyetje:Cili është fryti i diturisë?

imami i mirënjohur thotë:Fryt i diturisë është të praktikuarit tij. Patjetër dituria ne teori duhet të kalojë në praktikë.

DHE I SHËRON ZEMRAT E BESIMTARËVE

Pyetje :Zoti i Lartmadhëruar thotë:Dhe i shëron zemrat e popullit besimtarë. Po ashtu

thotë:Dhe shërim për atë çka ka në zemra. A është për qëllim shërim abstrakt apo shërim konkret pra të pjesëve të trupit?

Përgjigjja:Në lidhje me këtë Imami thotë:Mos e ngushto të zgjeruarën. Organizmi i njeriut ende është i panjohur ,nuk dihet përpos organet e jashtme të cilat shihen p.sh. sistemi i tajitjes ose sistemi i trurit apo urinor, apo gjinekologji. Pastaj shohim se për çdo ditë zbulohet diçka e re. Ndoshta një pilulë e vogël (e dehjes) vetëm pse depërton në tru e bllokton tërë trurin dhe ende për te nuk dihet asgjë. Secili sistem organik e luan rolin e tij dhe përderisa sa sistemi është i balancuar,pra në mes të lirit dhe shtrëngimit,pra shtrëngohet më shumë se sa është përcaktuar apo lirohet më shumë se sa ka rolin e tij. Zoti i Lartmadhëruar na sjell një shembull: “Që të mos dëshpëroheni për atë që nuk keni arritur ,as të mos krenoheni për atë që u ka dhënë”Pra përmbajuni mesatares. Njeriu i cili në rastet e gëzimit apo të pikëllimit vetëpërmbahet organi i tij është i shëndoshë dhe stabil i drejtë dhe i qëndrueshëm dhe veprimet të cilat paraqiten i përjeton me lehtësi.

Shërimi çka ka në zemrat përfshinë të gjitha llojet e sëmundjeve pa marrë parasysh a janë psikike a shpirtërore apo fizike, pra siq e quajmë në sëmundje psikike apo shpirtërore që do të thotë çdo lloj sëmundje e cila paraqitet në një organ prej organeve fizike e që në ende nuk kemi zbuluar e quajmë sëmundje shpirtërore,e kur t'ia zbulojmë bazën atëherë ajo sëmundje e merr titullin në bazë të bazës , pra sëmundje organike.

Pyetje:Çka nënkuptohet me fjalën „shërim dhe a ka shërim me fjalë?

Në një rast Raziu e ka quajtur me fjale pyetësin dhe ai është hidhëruar për së tepërmi , është dridh dhe në fundi bie të fikët .Pastaj Raziu i thotë të kemi hidhëruar me fjalë!! Ai i cili sëmurët me fjalë ai edhe shëron me fjalë. Shërim nënkupton rikthyerja e organit të njeriut në gjendje normale dhe stabile , pra në balancim. Çdo trazirë në sistemin e tij gjendet në moral dhe karakter. Njeriu normal të gjitha sistemet e trupit i ka standart dhe të balancuara.

Pyetje :A mundet që njeriu të jetojë pa frikë pa pikëllim dhe pa sëmundje?

Përgjigjja: Nëse njeriu ka iman(besim) nuk mund ta dëmtojë asgjë përpos nga jashtë prej veprimit të jashtëm si thyerja e dorës prej dikujt tjetër e të ngjashme. Mirëpo edhe kjo është si rezultat i mosqëndrimit të organeve në gjendje normale dhe sistemit të tij sipas planprogramit të Allahut

O JU TË CILËT BESUAT

Pyetje:Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:O ju të cilët keni besuar kini kujdes.

Po ashtu ka thënë:O ju të cilët keni besuar mbrojeni veten tuaj dhe familjen tuaj prej zjarrit ,ku lëndë djegëse në të janë njerëzit dhe gurët"

Po ashtu ka thënë:O ju të cilët keni besuar , mos t'ju shkatërroj pasuria juaj dhe fëmijët tuaj duke mos kujtuar Allahun"

Po ashtu ka thënë:O ju të cilët keni besuar,ka prej bashkëshortëve tuaja dhe fëmijëve tuaj të cilët jan armiq të tuaj ,andaj keni kujdes dhe ruajuni prej tyre"

Po ashtu ka thënë:O ju të cilët keni besuar pendohuni te Allahu me pendim të pastër dhe të sinqertë. Në këtë ajet dhe ajete tjera Zoti i Lartmadhëruar iu drejtohet besimtarëve mirëpo në ajetet tjera thotë:

„O ju njerëz, frikojuni Zotit tuaj,nuk ka dyshim se tronditja e çastit të kijametit është çështje shumë e madhe. Këtu iu është drejtuar njerëzve në përgjithësi ,si individ por edhe si besimtarë. Pse ndonjëherë iu drejtohet vetëm besimtarëve e ndonjëherë njerëzve?

Përgjigjja:Bazë e praktikimit të programit të Allahut është Imani(besimi) .Për këtë arsye kur Allahu i drejtohet robërve të tij në praktikimin e programit të Tij gjithmonë thotë: „o

ju të cilët keni besuar"e kjo formë përsëritet në shumë ajete. parashtrahet pyetja:Pse? Sepse bazë e praktikimit të programit të Allahut është besimi në Allahun,pejgamberët e Tij, melaqet e Tij, dhe çështjet e padukshme. Ky është çelësi e çdo gjë jashtë kësaj është e pavlerë nëse vepron diçka që ka urdhëruar Allahu por ti nuk beson vepra jote është e pavlefshme. Allahu i Lartmadhëruar ka urdhëruar me iu dhënë lëmoshë të varfërve për të fituar kënaqësinë e Allahut,dhe besim në Allahun dhe programin e Tij ,nëse beson në këtë ke shpërblim .Mirëpo ta konsiderojmë një njeri i cili jep lëmoshë që të thuhet se ai është fisnik ,ai i tubon të varfrit u ndihmon ,i përkrah , ju jep lëmoshë e me atë lavdërohet ,ai jep para njerëzve që ta shohin dhe le të flasin për te të, e tjerët vazhdimisht flasin për të, mirëpo kur ndonjë i varfër shkon të ai e kërkon ndonjë lëmoshë nuk i jep ai nuk i jep. Ai do reputacion ai nuk e do kënaqësinë e Allahut .Ky njeri nuk shpërblehet edhe pse ka bërë vepër të cilën e ka kërkuar Allahu i Lartmadhëruar,mirëpo ai ka vepruar po nuk ka besuar në Allahun,dhe nuk e ka bërë për Allah. Ai me zemër nuk beson në Allahun ,dhe tek ai nuk zbatohet thënia e Zotit të Lartmadhëruar:„O ju që keni besuar".kështu p.sh. një njeri falet para njerëzve ,mirëpo kur të jetë i vetmuar nuk falet. A shpërblehet ai për atë namaz? „asnjëherë, kurrë nuk shpërblehet,edhe pse ai vepron atë q ka urdhëruar Allahu,por është pa iman. Allahu i Lartmadhëruar nuk ka nevojë për ortak. Për këtë arsye çdo vepër e cila bëhet për ta fituar kënaqësinë e e Tij e pranon ,ndërsa nëse bëhet për të fituar kënaqësinë e njerëzve, Ai nuk ka nevojë për atë vepër,dhe nuk e pranon prej tij edhe pse është një pjesë e cila i kënaq njerëzit. Allahu i Lartmadhëruar është i pavarur nga gjithë bota

PSE SHTËPIA E SHENJTË DHE MUAJI I SHENJTË

A kanë lidhje mes vete fjalët „Iftaram-E shenjët" në fjalën e Zotit të Lartmadhëruar Shtëpia e Shenjtë dhe muaji i Shenjtë,apo secila ka kuptim në vete?

Përgjigjja:Imami i nderuar Shejh Muhamed Metveli Shaëraviju thotë:Kuptimi i fjalës „Shtëpia e Shenjtë" është sepse Allahu ka dashur që atë shtëpi ta bëjë të Shenjtë,dhe ka caktuar muajt e shenjtë për me ngop epshin e njeriut,njeriu ka epsh(zbrazëti) të cilën shejtani e ushqen vazhdimisht ,e ai ushqim pastaj ndikon me refuzuar kthimin te Allahu, dhe bën që ti marrin të shenjta çështjet tjera. Për këtë arsye edhe shtëpia e shenjtë është paqe për njerëzimin se ndoshta shpirti i njeriut qetësohet kur të hyjë në shtëpinë e shenjtë dhe po ashtu i ka caktuar muajt e shenjtë për të mos luftuar , ndoshta kjo do të ndikoj që njeriu të logjikojë dhe t'i ikë trazirave dhe konflikteve që shpijnë deri të lufta,dhe anojnë ka paqja, kur ti shikojmë të mirat e paqes. E Zoti i Lartmadhëruar me mëshirën e Tij ka dashur të arrihet ky sukses duke mos lejuar ngopjen e epshit njerëzor.

Për këtë arsye njeriu i cili dëshiron ta ndal luftën apo armiqësinë duhet të thotë:këtë ndërprerje e kam bërë për Zotin e Lartmadhëruar dhe kështu përfshihet me mëshirën e Allahut kur ta hapë derën e pendimit që njeriu ta ruaj ujin e fytyrës së tij dhe epshit të tij dhe ta bëjë një çështje të lehte e jo të rëndë. Për këtë arsye kjo dëshirë është e lehtë për tu penduar dhe stimulim për pendim. Nga këtu muajt e shenjtë janë armëpushim dhe ndërprerje e operacioneve ushtarake dhe të luftës e cila pastaj shpie përfundimisht në paqe të përgjithshme. Mirëpo Allahu i Lartmadhëruar nuk ka dëshiruar që ti më iu nënshtruar armikut kur ai të shpall luftë dhe të sulmon ty. Allahu ka urdhëruar që p.sh. gjatë muajve të shenjtë t'i lëmë armët dhe armiqtë tanë të vijnë të na presin e të na vrasin e ne tu themi ,na vrani sa të doni ,se ne nuk ju vrasim, sepse ne jemi në muajt e shenjtë .Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:Dhe mos luftoni (vrani) në Mesxhidil haram derisa nuk ju luftojnë (vrasin)juve në te. Nëse ju luftojnë luftoni ata. Po ashtu ka thënë:„të pyesin për muajt e shenjtë, saktësisht për luftën në ta.Thuaj:Lufta në ata muaj është mëkat i

madh,por largimi nga rruga e Allahut dhe mohimi i Tij dhe Mesxhdil Haramit ,po ashtu dëbimi i banorëve të vendit të tij është mëkat edhe më i madh te Allahu. Fitneja është mëkat më i madh se vrasja.

EL

BEKARE217

Nga kjo kuptohet , nëse bëhet luftë në muajt e shenjtë mos thuaj se më ke sulmuar në muajt e shenjtë ,sepse ti ke filluar armiqësinë dhe më ke sulmuar. Për këtë i nderuari Shejh Shaëraviju thotë:Muajt e shenjtë jan kohë e mbyllur për tu zgjuar ata të cilët luftën e konsiderojnë mjet të vetëm për zgjedhjen e problemeve të tyre,por gjatë kësaj kohe nuk lufton ,e cila kohë ju jep rast që në rend të parë ta shijojnë, ta përjetojnë dhe ta kuptojnë vlerën e paqes,dhe ti lënë armët e ti largohen luftës si nënshtrim ndaj urdhrat të Allahut. E nga këtu mbrohen tradhtitë dhe epshet, të cilat gjithmonë shkatërrojnë qenien njerëzore, dhe shpijnë në mundime të mëdha dhe largojnë nga Allahu. Kjo sepse tradhtia e lëkund imanin në shpirtin e njeriut dhe e trondit .Zoti i Lartmadhëruar prej momentit kur ka krijuar Ademin dhe ka caktuar vendin e Mekkes dhe shtëpinë në te vend të shenjtë ,ashtu siq e ka caktuar arafatin para se të ndërtohet Qabeja e nderuar , ndërsa Ibrahimimi dhe Ismaili jan ata, të cilët i kanë ngritë themelet e qabes , në atë vend ka qenë një ndërtesë e vogël, e kanë bërë tavaf rreth asaj shtëpie, kanë qëndruar ne arafat. Haxhi ka ekzistuar prej momentit kur është krijuar Ademi a.s. dhe prej momentit kur njeriu i parë ka zbritur në tokë.

KUPTIMI I BESIMIT RRETH GURIT TË ZI HAXHERUL ESVED

Cila është domethënia e ekzistimit të Haxherul Esvedit dhe pse janë gjurmët e këmbëve ,dhe a jan gjurmët e vërteta të Ibrahimit a.s. në gurë apo jo,dhe cila është vlere e rëndësia e gurit mbi të cilin janë gjurmët e këmbëve?

Imami i mirënjohur thotë:Qëllimi i mbetjes së këtij guri në atë vend të shenjtë ka domethënie të rëndësishme për përforcimin e Imanit. Allahu e ka urdhëruar Ibrahimin a.s. për atë gurë,dhe ai e ka bërë atë. po pse?Për ta ngritë objektin pak më lart. Ky gurë është bartur prej një vendi në vend tjetër për të përfunduar ndërtimi i objektit. E nga kjo buron kuptimi i Imanit. Sepse besimtarit nuk i mjafton vetëm me u ngarkuar me obligime , por të ketë edhe shtesa tjera, për këtë arsye edhe Ibrahimimi ka dashur që të shtoj diçka përpos asaj çka ka qenë i obliguar. Për këtë arsye shohim se në Islam rukni kryesor i cili mjafton të kryhet vetëm një herë në jetë është haxhi për atë i cili ka mundësi dhe rrugën e ka të lirë,mirëpo kjo nuk është kurrfarë pengese që ai i cili dëshiron më përsëritë haxhin më shumë se një herë mund ta kryej nëse ka mundësi dhe nëse rruga është e lirë.

CILA DUA DHE KUR PRANOHET MË SË SHUMTI

Zoti i Lartmadhëruar thotë: Lutmëni Mua, do t'ua pranoj". Ne e dimë se lutja është truri i ibadetit, por pyes: Cila dhe kur pranohet më së shumti?„Lutmëni Mua dhe do t'ua pranoj" Përgjigjja:Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. Cila dua është më e pranuar ?Është përgjigjur:Duaja në thellësi të natës dha pas namazeve farze.

E ka regjistruar Ahmed

Në një rast tjetër ka thënë:„Duaja ne mes të ezanit dhe ikametit nuk kthehet prapë"

I kanë thënë:Po për çka të lutemi o i Dërguari i Allahut?

„Lutjuni Allahut për shëndet në këtë botë dhe botën tjetër.

E ka regjistruar Tirmidhiu

Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. : „Me çka ta përmbylim lutjen? Është përgjigjur „Me Aminë”

KËMBIMI I TË MIRËS ME TË KEQEN

Gjatë një viti dy herë kam dështuar në tregti dhe gati sa nuk e kam humbur tërë pasurinë time. Më ka mbetur mall i dobët dhe ajo është e tëra që e kam, prandaj këmbimi i mallit të dobët me mallin e mirë a është haram, apo në kushte të domosdoshme lejohet?

Përgjigja:

Bilalli e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. për këmbimin e *dy saave të hurmave* të kualitetit të dobët me *një saa të hurmave* të kualitetit të mirë, ai është përgjigjur:

“Kjo është kamatë e plotë, mos vepro ashtu. Mirëpo, nëse dëshiron të blesh hurma të mira, atëherë shiti hurmat dhe merri të hollat, e me ato të holla bli hurma të mira”.

(Muttefekun alejhi)

Fadeletu bin Abidi e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. për një “KALAD”, të cilën e ka pasur ari dhe hirz (thesar i ruajtur) dhe pasi që i ndanë e sheh se janë më shumë se dymbëdhjetë dinarë. Muhamedi s.a.v.s. i thotë: ***“Nuk shitet deri sa të ndahen veç e veç”.***

(E ka regjistruar Muslimi)

Ky është argument se çështja e MUDIT AXHVETUN, për afërsisht, është masë e dy litrave, andaj nuk lejohet që njëra prej masave të ketë më shumë se tjetra, sepse haptazi kjo është kamatë e pastër. E vërteta është se ndalesa ka ardhur në këtë formë, por ka hadithe të cilat e tregojnë ndalesën edhe në forma tjera.

Pyetje:

Kam një djalë të vëllait, pas vdekjes së babës të tij unë jam në përkujdesje të trashëgimisë së tij. Jam në gjendje të vështirë ekonomike dhe kam bankrotuar. A kam të drejtë të vë në lëvizje apo në qarkullim pasurinë e jetimit përkohësisht, apo kjo është haram - kuptohet që kur ai të rritet, pasuria e tij të jetë në të njëjtën vlerë ashtu siç ka qenë?

Përgjigja:

Një njeri e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.: “Nuk kam pasuri dhe jam duke u përkujdesur për një jetim”. Muhamedi a.s. i ka thënë:

“Shfrytëzoje pasurinë e jetimit, por pa e tepruar, pa e shkapërderdhur dhe pa e përzier me pasurinë tënde, dhe duke mos lejuar që në vend të pasurisë tënde të shpenzosh pasurinë e tij”.

Kur ka zbritur ajeti ***“Dhe mos iu afroni pasurisë së jetimit, pos me mirësi”***, aq shumë janë larguar nga pasuria e jetimëve, sa që pasuria e tyre (jetimëve) është prishur dhe nuk e kanë prekur, mishi i tyre është kalbur dhe nuk e kanë ngrënë. Pastaj

për këtë e kanë pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s., kështu që ka zbritur ajeti kur'anor:

“Dhe nëse i përziëni ata dhe pasurinë e tyre me pasurinë tuaj, atëherë ata janë vëllezër tuaj, se Allahu e di më së miri të keqin prej të mirit”.

(E ka regjistruar Ahmedi dhe Ehlu Suneti)

SHIKIMI I TË FEJUARËS

Pyetje:

Një djalë i ri musliman dëshiron të fejohej me vajzën time, ai e ka parë atë një herë, por tani kërkon që të ulet me të, të bisedojë me të dhe ta shohë. Pyetja është: Të shikuarit e vajzës, me të cilën është për qëllim martesë, a është haram apo jo?

Përgjigja:

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. pasi që e ka pyetur për fejesën e Mugirete bin Shuebetes, i ka thënë atij:

“Shko dhe shikoje (të fejuarën), sepse të shikuarit ndikon që më shumë të afroheni dhe ta doni njëri-tjetrin”.

Ai shkon dhe i tregon prindërve të saj atë që i ka thënë i Dërguari i Allahut s.a.v.s., mirëpo ata sikur nuk e dëshiruan një gjë të tillë. Vajza, i cila ishte prezent kur e dëgjoi kërkesën e tij, thotë: *“Pasi që i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë kështu, atëherë edhe le të bëhet, se përndryshe unë nuk pranoj”*. Pra, ai i ka dhënë rëndësi të shikuarit mes tyre. Pastaj tregon Mugirete – *“e pashë atë dhe u martova, pasi që u bë pajtimi mes nesh”*.

(E ka regjistruar Ahmedi dhe Ehlu suneti)

PROSTITUTI DHE PROSTITUTA

Çfarë dënimi parashihet për gruan e cila bën tradhti kurore me djalin e pamartuar?

Përgjigja:

Një njeri i ka thënë të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.: “Djali im ka qenë shërbëtor i këtij, dhe ka bërë prostitucion me gruan e tij. I kam dhënë njëqind dele dhe shërbëtorin. Për këtë i kam pyetur dijetarët, e ata më thanë se *djali im duhet të dënohet me njëqind të rëna dhe të internohet (largim nga vendlindja për një kohë të caktuar), ndërsa gruaja e tij duhet të ekzekutohet me gurëzim*. Muhamedi s.a.v.s. i thotë:

“Për Atë që shpirti im është në dorën e Tij, gjykoni mes vete siç e parasheh Libri i Allahut. Njëqind dele dhe shërbëtorin ktheje prapë, djali yt le të dënohet me njëqind të rëna dhe le të internohet një vit. O Enis, shko te gruaja e këtij, nëse ajo pranon se ka bërë prostitucion gurëzoje”.

Kur shkon, ajo pranon dhe e ka ekzekutuar me gurëzim deri në vdekje”.

(Muttefekun alejhi)

“I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka gjykuar për prostitutën e pamartuar internim një vit dhe dënimin prej njëqind të rënave”.

(E ka regjistruar Buhariju)

TË RREJTURIT NDAJ BASHKËSHORTES

A mund ta rrej bashkëshorten time me qëllim që mos ta komplikoj jetën bashkëshortore, sepse ajo është tepër e ndjeshme, e nëse e flas të vërtetën asaj, atëherë keqësohen çështjet e jetës sonë, ndërsa nëse e rrej (duke mos e ditur) ajo qetësohet. A është kjo haram?

Përgjigjja: Kjo pyetje i është bërë të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.: “A ta rrej gruan time?” I është përgjigjur: **“Nuk ka dobi prej rrenës!”** Pastaj e ka pyetur: “Por, o i Dërguar i Allahut, i premtoj dhe i them se e kam kryer premtimin?!” I Dërguari i Allahut s.a.v.s. është përgjigjur: **“Nuk ke mëkat për atë”.**

(E ka regjistruar Ahamedi)

SADAKAJA PËR TË VDEKURIN

Pyetje: A lejohet sadakaja për të vdekurin?

Përgjigjja: Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. nga një pyetës: “Nëna ime ka vdekur. A të jap sadaka për të apo jo?” – Është përgjigjur: **“Po”.**

(E ka regjistruar Muslimi)

Tjetri e ka pyetur: “Nëna ime ka vdekur befasisht, e mendoj se, po të kishte pasur rast për të folur para vdekjes, do të më kishte thënë që të jepja sadaka për të. A mund të jap sadaka për të?”. Është përgjigjur: **“Po”.**

(E ka regjistruar Muslimi)

Një tjetër e ka pyetur kështu: “Nëna ime ka vdekur dhe nuk ka lënë porosi. A i bën dobi nëse jap sadaka për të? Është përgjigjur: **“Po”.**

(E ka regjistruar Ahmedi)

Hakim bin Hazami e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.: “O i Dërguar i Allahut, në kohën e injorancës jam përbetuar se do të forcojë lidhjet farefisnore, do të liroj rob, do të liroj rob. A kam për ato shpërblime?” I është përgjigjur: **“Për atë të kaluar të begatshme e ke pranuar Islamin, dhe kjo është ajo e mirë”.**

(Muttefekun alejhi)

Aishja r.a. e ka pyetur Muhamedin s.a.v.s. për Ibn Xhedanin, i cili në kohën e injorancës i ka forcuar lidhjet farefisnore, i ka ushqyer të varfrit, e për ato veprime a do të ketë dobi. I Dërguari i Allahut s.a.v.s. është përgjigjur: **“Nuk ka dobi, sepse asnjë ditë nuk ka thënë “O Zoti im, m’i fal gabimet e mia në Ditën e Gjykimit”.**

ISLAMI DHE LAICIZMI

Pyetje: Çka do të thotë “Laicizëm”, e cila po përdoret nëpër fjalorë të rregullimit shoqëror?

Përgjigja: Fillimisht dua të sqaroj fjalën “Laicizëm”, ashtu që të kuptohet se ata gabojnë dhe kanë lajthitur në këtë emërtim.

Çdo të thotë “Laicizëm”? Do të thotë se kjo sillet në të gjitha çështjet, ashtu si argumentohet shkencërisht. Por, parashtrahet pyetja: Çka do të thotë “shkencë”? Shkenca është çështje bindëse. Unë jam i bindur në këtë ndodhi dhe në këtë realitet. Unë në këtë çështje sjelli argumente. Mirëpo a janë çështje bindëse teoremat, ku nuk mund të sjell argument, kur janë në pyetje çështjet lëndore?

Në çështje lëndore, praktike nuk ka çka të diskutohet më tej. Mirëpo si të jetë bindëse çështja e teoremës?! Nuk mundet, natyrisht jo.

Ne u themi atyre: - Ju po thoni: Laicizmi nuk ka të bëjë me fenë. Mirëpo, kush ka thënë se feja nuk është Laicizëm? Feja është Laike në shkencën e cila sjellë argumente bindëse. Në këtë nuk ka diskutim, sepse për këtë ka argumente bindëse lëndore. Feja, posaçërisht Islami, ka ardhur për ta ngritur shkencën, bile edhe ka domethënie më gjithëpërfshirëse. Mirëpo ti dëshiron që ta përkufizosh fjalën Laicizëm në kufij ku nuk bën pjesë çështja shkencore, e ajo është çështja teorike. Dëshiron që teoremën ta konsiderosh shkencë. E ne u përgjigjemi: - Kjo nuk është shkencë, sepse nuk është bindëse. Gabim është ajo që ju keni dashur që fjalën “*shtet laik*” ta përdorni përballë fjalës “*shtet fetar*”. Ky krahasim është gabim, sepse feja, posaçërisht Islami, kanë zbritur për shkencën, vetëm se shkencën e aktivizon në çështje bindëse dhe praktike, të cilat nuk ndeshet me fenë. Pejgamberi s.a.v.s. ka folur për çështje të cilat munden të kenë dimensione të ndryshme të veprimit dhe e ka thënë fjalën përfundimtare të fesë, në të cilat nuk ka çka të hulumtohet më tej. Ndërsa sa i përket çështjeve praktike, për ta nuk ka folur.

Kjo do të thotë se për çështjet shkencore të cilat vërtetohen dhe argumentohet nuk ka çka të flet askush. Pejgamberi s.a.v.s. na urdhëron që çështjet praktike mos t’i marrim nga thënia e askujt, por drejtpërsëdrejti prej argumentimit të çështjes, ndërsa sa i përket çështjeve që nuk vërtetohen dhe nuk argumentohen merrni nga unë.

“Dhe vërtet kjo është rruga ime e qëndrueshme, e drejtë dhe stabile, e mos pasoni rrugë tjera, të cilat u ndajnë juve nga rruga e vërtetë”.

“Po të pasonte e vërteta epsheet e tyre, do të shkatërroheshin qiejt dhe toka”.

Laicizmi me fushat e vërteta të saj është me Islamin. Mirëpo, Islami është kundër laicizmit i cili nuk është brenda fushëveprimit të vet, sepse ju çështjen e fesë e keni bërë çështje të epsheve, ndërsa epsheet nuk sjellin shkencë.

Kurse, sa i përket kundërshtimit mes fesë dhe Laicizmit, në esencë nuk ka kurrfarë kundërshtimi mes *shkencës dhe Laicizmit* në kuptim të vërtetë të tyre, dhe në mes të *Islamit*.

DEVOTSHMËRIA DHE ADHURIMI

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Ky është libër në të cilin nuk ka dyshim, është udhëzues për të devotshmit”.

Po ashtu Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“O ju njerëz bëhuni të devotshëm ndaj Zotit Tuaj, se nuk ka dyshim se tronditja e Ditës së Kijametit është çështje e madhe (dhe e trishtueshme)”.

Po ashtu ka thënë:

“Adhurojeni Zotin tuaj, i Cili ju ka krijuar juve dhe të tjerët para jush, me qëllim që të jeni të devotshëm”.

Këto tregojnë se devotshmëria është qëllim i adhurimit, prandaj bëhet pyetja: Çka është ajo “që të jemi të devotshëm në adhurim”?

Imami i nderuar, Shejh Shaëraviju, thotë:

- Nëse e **konsiderojmë** devotshmërinë me kulminacionin e devotshmërisë do të shohim se ajo i ka cilësitë e të Madhërishmit ose gjurmët e cilësive të të Madhërishmit, ose që të dyjave së bashku. Ti me devotshmëri **pastron** cilësitë e të Madhërishmit, pastron gjurmët e cilësive të të Madhërishmit. Pastron njollat që njollosin jetën dhe vetën tënde, të pasurisë tënde, që të orientohesh në epiqendrën e adhurimit në tokë, e gjithë kjo është devotshmëri. Mirëpo kulminacion të devotshmërisë janë cilësitë e të Madhërishmit. Bëhu i devotshëm në të gjitha pjesët e jetës tënde e nëse këtë e ke realizuar atëherë ti veç e ke adhuruar Allahun.

Po t’i afrohej toka diellit, më shumë se sa është tani, do të çrregullohej jeta, por edhe po të largohej më shumë se sa është tani. Kështu që nëse afrohet, ngulfatemi, nëse largohet ngrihemi nga të ftohtit. Allahu ka parapa këtë largësi me urtësinë e Tij. Allahu ka kërkuar prej nesh që ta adhurojmë Atë, sepse Ai është Zot. Përderisa Ai është Zot, meriton të dëgjohet në atë që urdhëron të veprohet dhe të largohemi nga ajo që urdhëron të largohemi; jo për shkak se është mirë, por për shkak se është detyrim të adhurohet Ai, e pastaj e ka sqaruar qëllimin, e ai qëllim është që të jemi të devotshëm. Të larguarit nga një çështje e dëmshme nënkupton adhurimin ndaj Allahut e cila na mbron nga çdo çështje e cila na bën dëm, e pastaj të jemi të mbrojtur nga zjarri i xhehenemit në botën tjetër.

NATYRSHMËRIA NUK PRANON IDHUJTARINË

Pyetje: Natyrshmëria në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit nuk pranon idhujtarinë, mirëpo ajo çka ndodh prej idhujtarisë së fshehtë dhe jo të fshehtë është depërtim i shejtanit në thellësi të shpirtit të njeriut në njërën anë, ndërsa në anën tjetër dominimi i kushteve dhe rrethanave ideore, fetare dhe sociologjike etj. etj.

Nëse gjykojmë sipas natyrshmërisë, atëherë shohim se natyrshmëria nuk pranon idhujtarinë, por e pranon dhe qetësohet me Njëshmërinë e Krijuesit, e assesi nuk pajtohet me diçka tjetër, apo të zëvendësohet me diçka tjetër. Çka mendon Shejh Shaëraviju në lidhje me këtë?

Imami i nderuar thotë: - Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Dhe mos i bëni Allahut rival e partner deri sa ju e dini (se nuk ka)”.

Pra, mos i bën Allahut partner, shok e rival deri sa e dini se ata nuk krijojnë asgjë, nuk e kanë bërë tokën shtrojë, nuk e kanë ngritur qiellin lart dhe nuk zbresin shi nga qielli. Ju e dini se ata asgjë nuk kanë bërë në këtë drejtim, e pra pse ia keni bërë shokë dhe partnerë Allahut pra?! Thua se Allahu dëshiron të na thotë: Sillni Allahut rivalin që ta kundërshtoj, duke i thënë jo. Unë jam ai i Cili e kam ngritur lart qiellin, Unë jam ai i Cili e kam zbritur ujin (shiu) nga qielli. Po nëse nuk i kanë bërë këto dhe nuk kanë përgjigje, atëherë nuk lejohet që ata të jenë shokë, partnerë apo rival, e nëse i kanë krijuar, atëherë pse nuk po thonë: jo ti i ke krijuar?

Atëherë pse idhujtarët t’i bëjnë shok e rival Allahut? Kjo nga arsyeja se idhujt nuk kushtëzojnë asgjë në jetën e idhujtarëve, ashtu siç kushtëzon Allahu në jetën tuaj. Ju i keni bërë Allahut idhull, atëherë kur Allahu ka kushtëzuar jetën tuaj, mirëpo Allahu ka kushtëzuar për shkak se ka dashuri në ty, sepse Ai kur e ka kushtëzuar jetën tënde Ai në të njëjtën kohë ka kushtëzuar miliona njerëz për dobinë e tyre. Ndërsa sa i përket idhujve, ata asgjë nuk kërkojnë nga ju, ky është shkak se pabesimtari i do idhujt, siç ju e doni Allahun, mirëpo besimtarët e donë edhe më shumë Allahun. Kjo nga shkak se Ai ka kushtëzuar jetën tonë për të mirën e sigurisë dhe qetësisë sonë.

Vështroni fjalën e Zotit të Lartmadhëruar:

“Dhe kur t’i ndodhë njeriut ndonjë fatkeqësi apo vështirësi thërret dhe i lutet Zotit të vet”.

E pse nuk thërret dhe nuk i lutet idhullit në atë çast? Nga shkak se ai e di se ai idhull nuk ka krijuar dhe nuk posedon mundësinë e largimit të fatkeqësisë dhe vështirësisë, e nuk mund të ndihmojë asgjë, për këtë arsye i drejtohet Zotit të Vërtetë, i Cili pronëson çdo gjë, dhe i Cili çdo gjë e ka në kompetencën e Tij. I kthehet Atij (Allahut). Fjala “u kthye” tregon se ka qenë i larguar nga Ai dhe pastaj është kthyer.

Vështroni fjalën e të Madhërishmit:

“Pastaj kur t’ia ndryshojë atij vështirësinë, i ndihmon, ai harron atë se çka është lutur dhe kujt i është lutur më parë”, dhe është kthyer te idhujt, pasi që Allahu ia ka tejkualuar vështirësinë dhe fatkeqësinë. Allahu i Madhërishëm thotë:

“Dhe i ka bë Allahut shok, rival e partner për të humb nga rruga e Tij. Thuaj: Kënaqu pak me pabesimin tënd. Sepse kjo nuk do të zgjasë gjithmonë, por nuk ka dyshim se ti je prej banuesve të zjarrit”.

ÇKA PËR SUNETIN E PEJGAMBERIT S.A.V.S.

Pyetje: Prej risive dhe shpikjeve të këqija dhe të rrezikshme, të cilat po ndodhin në mes të zemrës islame, është risia e mohimit të sunetit pejgamberik dhe bazimi vetëm në Kur’an në çdo çështje të shariatit dhe obligimeve.

Mospranimi i sunetit fisnik, i cili është sqarim dhe komentim i Kur’anit fisnik, është çështje e rrezikshme. Pra, kjo do të thotë se Islami ia ndalon Pejgamberit s.a.v.s. t’i sqarojë çështjet dhe komentimin e tyre të cilat kanë zbritur në Kur’an.

Nga kjo shihet se është e patjetërsueshme të definohet kjo çështje, të cilën, të dyshimitit e sjellin në dyshim andej e këndeje. Çka mendon Shejh Muhamed Muteveli Esh-Shaëraviju në lidhje me këtë?

I nderuari Shejh Shaëraviju thotë:

Përsëritja dhe praktikimi i vazhdueshëm i sunetit deri në ditën e sodit është mrekulli prej brendësive të mrekullive të Kur'anit, dhe ata, të cilët dyshojnë dhe sjellin dyshime për sunetin, sfidohen me dyshimin në veten e tyre. Me fjalë tjera me sjellje të dyshimit në sunet, ata në të vërtetë sjellin dyshim në vetë mrekullinë Kur'anore, për arsye se Zoti i Lartmadhëruar në librin e Tij thotë:

“Dhe Ne ta kemi zbritur ty Kur'anin që t'u sqarosh njerëzve çka u ka zbritur atyre, ndoshta ato do të mendojnë”.

Detyrë e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. është që të sqarojë atë çka i ka zbritur atij. Pastaj Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Vërtet detyrë e Jona është tubimi i tij, dhe leximi i tij. Dhe kur ta kemi lexuar (ta lexojmë) përcjellja jote duhet të jetë në leximin e tij, e pastaj, vërtet ne e kemi për ta sqaruar”.

Zoti i Lartmadhëruar ka treguar se e ka obliguar të Dërguarin e Tij të sqarojë atë, kur ka thënë: **“Që t'u sqarosh njerëzve”**, e pastaj ne kemi për ta sqaruar atë. Po të mos kishte qenë i vërtetë dhe obligim për muslimanët sqarimi i Pejgamberit, Zoti i Lartmadhëruar nuk e kishte treguar se ai e sqaron. Besimi në mbështetje dhe të ekzistuarit të sunetit të Pejgamberit s.a.v.s. është mrekulli e brendshme e Kur'anit.

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Dhe çka u ka dhënë juve i Dërguari pranojeni, dhe çka u ka ndaluar juve për diçka, ndalohuni. Frikujuni Allahut. Vërtet Allahu është i ashpër në dënim”.

Kjo tregon se Pejgamberi s.a.v.s. është në bashkëveprim me Kur'anin, e përderisa është në bashkëveprim me Kur'anin ai patjetër duhet të flasë për Kur'anin, të veprojë sipas Kur'anit ose ta pranojë atë çka e thotë Kur'ani, por kjo është për gjeneratën e tij, ndërsa për ata pas tij kërkohet që të pranojnë atë çka e thotë i Dërguari i Allahut s.a.v.s.. Për këtë arsye është e patjetërsueshme të mbetet fjala e tij, veprimtaria e tij, pranimi i tij ose mosveprimi i tij për diçka.

Pasi që i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka kumtuar prej Zotit të tij njëzet e tri vite, fjala e tij, veprimtaria e tij, pranimi i tij për ndonjë veprim në prezencë të tij është sqarim. Për Zotin, ata që sjellin dyshim në sunet le të na tregojnë. Sa fjalë Pejgamberi s.a.v.s. nuk i ka thënë duke sqaruar çka i ka zbritur atij prej Zotit të tij apo çka e ka urdhëruar Zoti i tij.

Atëherë, nëse paraqesim se çka ka mbetur prej haditheve të vërteta do të shohim se çka ka mbetur është shumë e pakët nga ajo çka ka dashur të mbes. Kanë mbetur shumë hadithe që t'i vërtetojmë me anë të formave të ndryshme, analizave të ndryshme dhe analogjisë që ta pranojmë atë që e ka thënë Pejgamberi s.a.v.s.. Më mirë është që të lihet diçka çka ka thënë, se sa të depërtojë në hadith diçka çka nuk e ka thënë.

Ata të cilët dëshirojnë që vetëm Kur'ani të jetë bazë dhe mbështetje, ata duhet të na gjejnë zgjidhje në Kur'an për detajet e shtyllave të Islamit. Nuk po them për mësimin dhe studimin e Islamit. Vërtet ata janë që e kanë tepruar ndaj vetes së tyre dhe i janë qasur kësaj loje, përderisa vetë janë dëshmitarë për hadithi e Pejgamberit s.a.v.s. se është i vërtetë. Sepse për ta ka treguar me hadithe vet Pejgamberi s.a.v.s. dhe ka treguar se të tillë do të ketë edhe në të ardhmen. Po mos ta kishin mohuar sunetin dhe po të mos kishin thënë çka ka thënë, për t'u bazuar vetëm në Kur'an, nuk do ta kishin hasur hadithin i cili vërteton për ta. Kur Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

“Është e mundur që një njeri të mbështetur në kolltukun e tij të thotë: Në mes nesh dhe jush është libri i Allahut; çka të jetë e lejuar në të e lejojmë, e çka të jetë e ndaluar, e ndalojmë. Por ta dini, se çka e ndalon i Dërguari i Allahut është identike me atë çka e ka ndaluar Allahu”.

Po të kishte qenë ndryshe, apo, po mos të kishin shpifur këta dhe mos t'i kishin hyrë kësaj valle, ne do të kishim dyshuar në këtë hadithë të Pejgamberit s.a.v.s.. Mirëpo, vetë thënia e tyre ashtu është argument se, ajo çka thonë dhe pretendojnë ata është rrenë.

DËGJOJENI ALLAHUN DHE TË DËRGUARIN

Pyetje: Zoti i Lartmadhëruar në librin fisnik ka thënë:

“Dëgjojeni Allahun dhe të Dërguarin”.

Ka thënë:

“Dëgjojeni Allahun dhe dëgjojeni të Dërguarin”.

Ka thënë:

“Dëgjojeni të dërguarin”.

Në mes të tre këtyre urdhëresave, a kanë ndonjë dallim të cilat përsëriten në forma të ndryshme në këto ajete?

Përgjigjja:

Imami i nderuar, Shejh Shaëraviju përgjigjet:

- Kur Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“Dëgjojeni Allahun dhe të Dërguarin”**, do të thotë se Allahu vendos një ligj, ndërsa edhe i Dërguari flet për atë ligj. Pra, unë nuk e përsëris dëgjueshmërinë, unë i dëgjoj që të dy, sepse të dy urdhërojnë të njëjtën çështje.

Allahu na ka urdhëruar të falemi, Pejgamberi s.a.v.s. na ka urdhëruar të falemi; Allahu na ka urdhëruar të japim zekat, Pejgamberi s.a.v.s., gjithashtu, na ka urdhëruar të japim zekat. Pra, dëgjuesi në të njëjtën kohë kryen urdhrin e të dyve.

- Kur Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“Dëgjojeni Allahun dhe dëgjojeni të Dërguarin”**, Allahu urdhëron në mënyrë të përgjithshme, ndërsa i Dërguari e detajon atë urdhër. Unë e kam dëgjuar Allahun kur ka urdhëruar në mënyrë të përgjithshme dhe e kam dëgjuar Pejgamberin kur e ka detajuar atë çështje.

- Ndërsa kur Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“Dhe dëgjojeni të Dërguarin”**, Allahu nuk ka urdhëruar për atë çështje, por Pejgamberi urdhëron. Nga kjo, Allahu kur e thotë këtë ajet në të njëjtën kohë thotë: **“dhe kush e dëgjon Pejgamberin e ka dëgjuar Allahun”**, që mos të mendohet se të dëgjuarit e të Dërguarit nuk është dëgjueshmëri ndaj Allahut. Po pse? Sepse Pejgamberi është i autorizuar prej Allahut. Unë kur e dëgjoj të autorizuarin e kam dëgjuar autorizuesin.

SHOQËRIA PARAZITE

Ne kohë te fundit është mbajtur një kongres ekonomik i cili zgjati disa ditë të shteteve të mëdha, ku morën pjesë ekspertet dhe profesionistët e profileve të shumta. Pasi u paraqiten me dhjetëra punime hulumtime, dhjetëra e dhjetëra mendime e propozime, që te gjitha ishin te përqendruar në mënyrë te veçantë për problemin e ushqimit të banorëve, të prodhimit, dhe me atë se investohet dhe shpenzohet shumë pak me këtë çështje. Këtë

çështje ia parashtruan imamit te nderuar Shej Shaëraviut i cili tha: Përgjigjja: sistemi me te cilin kemi jetuar një kohë të gjatë është sistem shumë larg nga islami dhe nga politika njerëzore. Ti nuk po vepron sipas sistemit dhe politikës njerëzore e pastaj po thua: Më shkatërron feja. Kjo nuk është e drejtë, sepse themelet I ka të brishta. Do të kisha pasur te drejtë ta akuzoj nëse kam praktika atë sistem. Mirëpo aktivitetit im që nga starti është jo I shëndoshë e unë nuk kam të drejtë që për këtë ta akuzoj islamin.

Jo, por unë duhet të them. Nuk veproj më me këtë sistem, por veproj me islam. Bazohem në planprogramin islam, pastaj nëse ballafaqohesh me vështirësi ekonomike, ti nuk je ballafaquar më me islam por me politikën ekonomike njerëzore. Statistaret a janë te sigurtë ne diagnozistikimin e sëmundjes, apo thjesht vetëm flasin andej këndeje, e nuk sjellin argumente. Asnjëri nuk na sjell argumentin e të na thotë: shkak i kësaj krize është se ne jemi shoqëri parazite. A nuk kemi ne tokë që ta shndërrojmë ne tokë pjellore. Pse gjatë një periudhe të gjatë të mëparshme nuk kemi shndërruar në tokë pjellore para se të shtohet numri I banorëve!!?

Atëherë, atë që sot po themi është mangësi të cilën kemi mundur të eliminojmë më herët. Pra, a paskemi pasur të eliminojmë këtë më herët apo jo?

Normalisht se kemi mundur. Po të kishe punuar një periudhë të gjatë kohore, dhe ti tejkalosh shkaktaret e krizës, ka pasur mundësi që sot , të mos ketë krizë.

Sikurse çdo gjeneratë ta ketë pasur parasysh që ta prodhojë dyfish(nga nevoja e vet) ose së paku ta prodhojë aq sa merr(nga gjenerata e kaluar). Ose sikur çdo njëri të jep aq sa ka marrë . Çfarë rezultati do t kishim ? .Normalisht jo krizë, mirëpo ne, e marrim e nuk japim. Ashtu siç po ndodh tani, ushqimi ynë nga eksporti!!

Çka duhet të ndodhë: Ose të mos ushqehemi nga tjetri, por të shtrëngoj rripin duke vendosur ne bark gurë, ose të udhëtoj jashtë vendit tim e të ushqehem. Unë nuk mund të jetoj më shumë sipas mundësive të mia.

Ne kemi thënë : Janë tri çështje. Prodhimi dhe shpenzimi. Nëse është I barabartë prodhimi me shpenzimin vjen deri te ngecja. Nëse shpenzimi është më I madh se prodhimi vjen deri te shkatërrimi I parakohshëm. Nëse prodhimi është më I madh se shpenzimi vjen deri te zhvillimi. Ndërsa ne, përderisa shpenzojmë më shumë se sa prodhojmë atëherë patjetër rezultati ynë është se jemi vonuar.

Sikur çdo gjeneratë prej gjeneratave, apo çdo vend prej vendeve I jep popullit aq sa ka marrë çështje do t kishte qenë ndryshe(do të thotë, nëse jam shërbyer prej dy arive. Nëse punoj gjatë tërë jetës dhe e shndërroj në tokë pjellore një hektar e tjetri po ashtu një hektar. Atëherë të gjithë do të ishin të pasur, mirëpo ne rrimë neglizhent një shekull, e pas kësaj e veprojmë për një ditë.

Çështjet duhet ti zgjedhim me zell dhe guxim, dhe çështjet zgjidhen me përgjegjësi dhe në mënyrë sistematike. Nëse i bëjmë një vështrim zgjedhjes së krizës ekonomike, shohim se ata të cilët diagnostifikojnë krizën dhe shkaqet e krizës, shohim se ata flasin për sistemin ekonomik të tanishëm. Ata nuk kanë guxim të thonë: Sistemin ekonomik të cilin e kemi është sistem I brishtë, sistem jo natyrorë dhe I papërshtatshëm dhe përderisa vazhdojmë me këtë sistem, jemi shumë larg nga zgjidhja e problemit të krizës.

A ka mundësi që ndonjëri të thotë: Punëtorët shtetëror (Qeveritarët) nuk prodhojnë aq sa marrin prej shtetit? Kush ka guxim ta thotë këtë posaçërisht për Qeveritarët: A prodhojnë aq sa marrin! Unë them jo...!

DHE JENI NË LUFTË ME ALLAHUN

Çështja e kamatës, problemet dhe krizat që rezultojnë prej saj posaçërisht kur sistemet ekonomike në botë janë shkatërruar në një trup dhe ato së bashku kanë vendosur ligje e rregulla të cilat nuk mund ti shpëtojë asnjë shtet, posaçërisht të botës së tretë apo të vendeve të pazhvilluara me u ballafaquar me ata cilët janë ngarkuar me borxhe me plotësim të kritereve dhe kushteve të ditëpërditshme.

Me një fjalë, këto vende të vogla janë te udhëhequra prej vendeve të mëdha për shkak të borxheve dhe rritjeve të kamatave. I nderuari ynë. Çfarë zgjidhje parashihni.

Përgjigjja: Zgjidhja e problemit qëndron në atë se shteti I sëmurë a dëshiron sistem të cilin nuk e kanë shtete të mëdha dhe të cilat e pranojnë se është I mire, e pastaj me ardhur dhe me mësuar islamin.

Për këtë kemi argument. A ka ndonjë shtet i cili ka filluar me sistemin ekonomik islam apo jo. A e kam praktiku apo jo? A e ka pengu ndokush kur e ka filluar atë sistem apo a e ka kundërshtuar. Unë dëshiroj të bëj krahasim në mes të sistemeve. E pas krahasimit nëse shoh se është I mire e pranoj, e nëse nuk është I mire u themi, për Zotin ju e keni gabim për këtë, për këtë. Mirëpo kjo nuk ka ndodhë?

Pastaj bazë kryesore e sistemit të ne është sistemi kamatarë. A mundemi me stabilizuar gjendjen me sistem kamatarë. Zoti i Lartmadhëruar askujt tjetër nuk i ka shpall luftë pos atij i cili vepron me kamatë.

Përderisa vendet në Amerikë kanë ardhur dhe e kanë marrë sistemin e bankave islame, po ashtu edhe vendet evropiane sepse e kanë pa se është më I volitshëm, sepse dëshmon teori të re ekonomike. Se borxhi nuk mund të lahet deri sat ë kthehet kamata në 0%.

Ata, këtë dëshirojnë ta marrin nga islami, e ta praktikojnë ndërsa në anën tjetër, ende ka dijetarë islam të cilët dëshirojnë me arsyetuar sistemin ekonomik të tyre, ata dëshirojnë ta largojnë sistemin ekonomik të tyre dhe të vendosin sistem të ri, ndërsa ne ende e mbrojmë, kjo është e pa logjikshme. A nuk pajtohesh në këtë çështje me mua.

NATALITETI I MADH

Pyetje:

Nataliteti I madh, a mos asht prej pengesave kryesore të zhvillimit ekonomik?

Përgjigjja: Është e vërtetë se kemi natalitet të madh, kjo është e pamohueshme. Ne kemi krahasuar dhe kemi bërë analiza, të cilat sjellin shkatërrime. Ashtu siq thonë ata në vitin 2000 është po ashtu e vërtetë. Por parashtrohet pyetja: Pse? Ne kemi bërë llogaritjen e numrit të banorëve në vitin 2000, ndërsa nuk e kemi bërë llogaritjen se sa sipërfaqe të tokës nevojitet për atë numër të banorëve.

Çka kemi arritur? Ti ke thënë: se do ta zvogëloj numrin e banorëve. Kjo do të thotë se ti ke shikuar vetëm anën negative , e nuk e ke llogaritur anën pozitive. Në vend se të thuash: Në vitin 2000 për këtë numër të banorëve nevojitet kaq e kaq sipërfaqe të tokës, kaq fabrika e pastaj punon për shtimin e sipërfaqe së tokës dhe të fabrikave. Ti ke shikuar anën e dobët dhe ke thënë: Jo, numrin e banorëve do ta zvogëlojmë.

Pra ti ke llogarit shtimin e popullsisë për çdo vit e pastaj ke arrit te numri I popullsisë në vitin 200. E vërtetë është numër I madh, natalitetet i madh, e pastaj ti thua: patjetër duhet të zvogëlojmë këtë numër. Pse ti në vend se të thuash. Të shtojmë prodhimin thua ta zvogëlojmë numrin e banorëve. Pra ti ke shikuar vetëm anën negative, e cila të bënë të plogësht dhe përtac e nuk e shikon anën pozitive të prodhosh kaq. Të punosh këtë ditë. Të

bëhesh I përgjegjshëm dhe të planifikosh e të realizosh projekte. Ne kemi shikuar anën e cila nuk kërkon lidhje e mundim, dhe kemi kërku prej tjerëve zvogëlimin e numrit të popullatës,, Ju falënderojmë, mire do ta zvogëlojmë . Nëse do Allahu!!

Nëse shikojmë çështjen në jetën e rëndomtë individuale, do të shohim se çështja ndryshon. P.sh Një individ thotë: Unë kam tre fëmijë, të ardhurat personale I kam katërdhjetë lira egjiptase dhe shtesë marr kaq etj etj. A mjafton kjo ? Normalisht se nuk mjafton Atëherë patjetër duhet gjetur punë pas dite.

Merrem me tregti në dyqanin tim nëse jam tregtar ose punoj taksist, ose ne ndonjë trafik. Kështu ua plotësoj nevojat anëtarëve të familjes. Ti angazhohesh dhe e lodh vetën tënde për ekzistencën, dhe nuk shikon më vetë ekzistencën e të thuash: E pakësoj këtë anëtarë dhe atë anëtarë, Ti nuk vepron kështu. Kur shtohet numri i anëtarëve ka ngushtim të ekzistencës, ndërsa nëse vërën para se të ndodh kriza nuk do të kesh ngushtim dhe vështirësi.

Ne si shoqëri, parapraktikisht nuk kemi bë asgjë për atë që do të ndodhë për shtimin e popullsisë. Për këtë arsye kur thuhet se pejgamberi s.a.v.s ka kërkuar mbrojtje tek Allahut prej varfërisë dhe numrit të shumtë të anëtarëve në familje (I përgjigjemi): po që te dyja nëse janë në të njëjtën kohë!! Ti pse ke planifikuar shumë fëmijë, e nuk e ke planifikuar për të qenë i pasur por ke mbetur i varfër? Pse nuk je angazhuar në jetë për ta zhduk varfërinë? (ka njerëz e kanë shikuar të dytën nuk janë brengosur për të parën. Pra ia kanë arritur qëllimin ta zhdukin varfërinë e nuk ka ndikuar te ta asgjë numri i madh i anëtarëve në familje)

Kur është pyetur Shejhu për projektet ekonomike islame, dhe sit ë arrihet deri te rruga e dritës, e cila zgjedhë shumë probleme të kohës bashkëkohore. Dhe cili është shkaku mos bashkëpunimit në mes të dijetarëve të fesë dhe ekonomistëve.

I nderuari është përgjigjur: sepse ai I cili flet për fe nuk ka eksperiencë për sistemin njerëzore. Ai I cili flet për sistemin e njerëzve nuk ka eksperiencë në fe. A ka ndokush që I bashkon këto dy eksperiencia, të bëhet unifikimi i botëkuptimeve, të unifikohet qëllimi. Shpresoj të ndodh kjo.

ARMA E KARAKTERIT (MORALIT)

Pyetje: A është në kundërshtim mendimi I perëndimit bashkëkohore i cili dëshiron që edukatën fetare ta zëvendësoj me karakterin njerëzore. Pra atë që feja kërkon prej njeriut të jetë I devotshëm si fuqi apo force qe njeriun e largon prej të keqes në humanitetit mendojnë që ta zëvendësojnë me karakterin njerëzore pra në moral njerëzor.

Përgjigjja: Çfarë kuptim ka fjala „ karakter’’. Çka është karakteri, karakteri I kujt. Karakteri im apo karakteri i këtij apo I atij. Çdo njëri është në gjendje të zbukurojë një çështje që e dëshiron, e pas kësaj zgjohet karakteri e tij, pasi që tërë botën e ka stërmbytur me të keqe. Karakteri nuk zgjohet për deri sa njeri nuk punon keq !! Mirëpo atë që dëshiroj unë është që të vendosi një mur (pengesë) në mes të njeriut dhe të keqes. E këtu mos thuaj fjalën karakter.

Pra çfarë kuptimi ka fjala karakter në islam. Do të kishte qenë më mire që kjo pyetje të parashtrohet. Karakteri është veprim në mes teje dhe vetës tënde, e cila të ndalon dhe të paralajmëron. Pra jo me të pengun nga jashtë: Pra ndjenjë fetare të cilën ne e quajmë karakter.

Më mbron nga çështjet në të cilat shoqëria nuk mund të më mbrojë. Sikurse civilizimi perëndimorë kapitalist ne do te kishim pasur këtë bashkëpunim me fenë e tyre nuk do të kishim mundur për këtë ide. Pra, përderisa fëmija ende nuk ka karakter(deri sa

të rritet). Fëmijën, të cilit dëshirojmë t'ia forcojmë. Veprimet për të cilët shoqëria është pajtuar se janë të këqija. Ku ka qenë karakteri p.sh I vajzave te cilat e shesin nderin e tyre. Ku ka qenë dhe ku është karakteri I tyre. Ku është karakteri i çështjeve të cilat rrezikojnë sigurinë shtetërore.

Themi po të kishte pasur më të vërtetë karakter, dhe ai karakter të qëndronte në mes të njeriut dhe të keqes, atëherë nuk do të kishte pasur nevojë që ata të ketë gjykata. Ka qen dashur të mos ekzistojnë gjykatat, bile edhe ligjet. Mirëpo e vërteta se ju keni qenë të detyruar të themeloni gjykata, e të vendosni ligje sepse ju nuk keni siguri në karakterin, bile edhe në këtë çështje!!

Të parashtrojmë një pyetje: sikur te ju të kishte diçka nga feja? Nuk ka dyshim se feja jo në islam apo në shtetet islame është vetëm fe politike. Nuk është fe e cila udhëheq apo ngarkon njeriun me obligime që të jetë me karakter që t'ia zgjon karakterin I cili zë vendin në mes tij dhe në mes të keqes të cilën vepron. Në islam karakteri është çështje të cilën e ndërton Allahu, e nuk e ndërton teknologjia.

LEJOHET SHFRYTËZIMI I MJETEVE TEKNOLOGJIKE

Pyetje: Mjetet bashkëkohore teknologjike si telefoni, televizori e prej aeroplanit e raketave. Zhvillimi teknologjik e sa e sa mjete komode për njeriun. Shfrytëzimi i këtyre mjeteve a është haram apo hallall. Muslimani këto mjete a duhet ti konsideroj begati me të cilat Allahu ka dëshiruar t'i begatoj, apo begati me të cilat Allahu dëshiroj ti dënojë në këtë botë, e pastaj ti marrë në përgjegjësi nesër në ditën e kijametit. Posaçërisht pasi që ato janë prodhim i perëndimit, të cilat laicizmi materialist I ka program. Kjo është çështje e cila na ka vë në sprovë i nderuari ynë.

Përgjigje:

Zhvillimi nuk ka të bëjë me teknologjinë. Nuk duhet të ngatërrojmë mjetet teknologjike me zhvillimin. Çka është zhvillimi? Këtu p.sh. ka mjete të cilat i shfrytëzojmë. Telefonin të cilin e shfrytëzojmë, televizorin të cilin e shfrytëzojmë. Aeroplanët të cilët i shfrytëzojmë, raketat të cilat i shfrytëzojmë. Pra për mjetet në vetvete nuk quhen zhvillim. Por shfrytëzimi i mjetit është ai i cili ka rezultuar prej zhvillimit. Për këtë arsye nuk duhet të përziejmë çështjet materiale me zhvillimin. Islami nuk refuzon çfarëdo zhvillimi material e teknologjik për derisa jan në shërbim të zhvillimit. Ti nëse dëshiron telefonin, shfrytëzimi i telefonit mos e cenon zhvillimin? Normalisht se nuk e cenon zhvillimin. Ne këtu po flasim për çështjen materiale. Mirëpo për çka po përdoret telefoni? Në të kaluarën kam luftuar me shpatë, ndërsa sot luftoj me raketa. Mjeti është mjet. Mirëpo në çka po e shfrytëzoj? Zhvillimi nuk ka të bëjë me mjetin por ka të bëjë me shfrytëzimin e mjetit. Nuk thuhet ky mjet është hallall e ky haram. Mirëpo pyetja bëhet: Në çka e ke shfrytëzuar këtë mjet.

Pra zhvillimi nuk ka të bëjë me teknologjinë: teknologjia quhen çështjet të cilat ia ofron mundësin jetës që të jetë sa më komode, sa më e lehtë , dhe sa më e shpejtë te përfitimi mirëpo cilat janë mënyrat e jetesës? Këtë duhet ta hulumtojmë ka zhvillim sjell zhvillim apo jo? Nëse e kanë prodhuar mizoret dhe kriminelët kjo është mire dhe e dobishme. Shfrytëzoje TV-në në edukimin e fëmijëve tu dhe zhvilloj në bazë të aftësive të tyre kjo është mire dhe e dobishme. Por nëse e shfrytëzoj që nëpërmes Tv-së në shtëpinë time të depërtoj devijimi, gjërat e degjenerimit dhe lakuriqësia kjo është sherr-keq.

Pra Televizioni nuk është „zhvillimi” në vetvete por është zhvillimi në bazë kësaj se si e shfrytëzon ti. Thika, a mos thuhet se thika është zhvillimi apo jo zhvillimi Jo, por

cilësohet në bazë të asaj për çka e përdori. Nëse prej atë që është hallall e lejuar është mire dhe e dobishme, por nëse e prej atë që është haram e ndaluar është e dëmshme.

Pra nuk lejohet të themi: Teknologjia është zhvillimi perëndimorë, por duhet të themi : teknologjia e këtyre mjeteve. Mjetet të cilët i sigurojnë njeriut zhvillim të shpejtë dhe nuk e lodhim I sjellin njeriut të mira shumë shpejt edhe me lehtësi. Mos thuaj Këto janë zhvillim. Por zhvillim është në shpenzimin e këtyre mjeteve. Ky është zhvillimi(modernizmi)!!

ABESE VE TEVELA – “U VRENJT DHE KTHEHU SHPINËN”

Pyetje: Disa armiq të islamit thonë se tërheqja e vërejtjes prej Allahut të Lartmadhëruar, peygamberit të Tij s.a.v.s. në suretu „Abese” tregon dobësinë e peygamberit fisnik. Dhe ky është një ajet prej ajeteve që është qortuar. Dëshirojmë, nga ju I nderuar të na sqaroni këtë çështje dhe të na largoni këtë dyshim, që ne të mos biem disa prej besimtarëve.

Përgjigjja: Le të shikojmë çështjen thelbësisht dhe me logjikë e të analizojmë së bashku, a është qortuar ashtu siq thonë ata „dobësi dhe paaftësi e peygamberit s.a.v.s.”

Në fillim: Ky I verbër i cili ka shkuar te I dërguari I Allahut s.a.v.s. është besimtarë apo pabesimtarë?. I verbëri i cili ka shkuar te peygamberi s.a.v.s. ka qenë besimtari i cili ka shkuar për të pyetur qështje prej çështjeve të fesë. Mospërgjigjja për ti sqaruar besimtarit a është çështje e lehtë apo e vështirë!? Nuk ka dyshim se mospërgjigjja ndaj besimtarit është çështje e lehtë. Ai njeri e pyeste të dërguarin përderisa ai ishte I preokupuar dhe I angazhuar me krye pabesimtarët, për t’iu kundërvënë atyre.

Nuk ka dyshim se kjo është shumë e vështirë në krahasim me të parën. Pra Allahu I Lartmadhëruar i ka thënë të Dërguarit të Tij : pse po e lodh dhe po e mundon veten me ata pabesimtarë, dhe humbë kohë me ta. Kjo është çështje e mundimshme për ty. Pra Zoti I Lartmadhëruar nuk e qorton pse është I hidhëruar me te por pse ai mundohet. Kjo do të thotë se po ia tërheq vërejtjen në dobi të Peygamberit s.a.v.s.

Të shikojmë qortimin në një rast tjetër ku Zoti I Lartmadhëruar I thotë: Pse po ndalon veten në atë çka Allahu ta ka lejuar ty. Këtu Zoti i Lartmadhëruar e pyet të dërguarin e Tij: Pse po e ngushton veten tënde. Kjo a mos është çështje e cila e dëmton dhe e vështirëson të Dërguarin s.a.v.s. apo është çështje që e lehtëson dhe e zgjeron.

Kjo është kështu. Për të ta bërë më të qartë. Nëse ti ke një fëmijë apo një vëlla I cili angazhohet për së tepërmi për të mësuar. Ai gjatë ditës është në shkollë ndërsa tërë natën mëson, përsërit mësimin dhe studion. E ti e qorton pse për së tepërmi po lodhet kjo është se ti e do dhe ke kujdes të madh ndaj tij e ky qortim në këtë rast nuk është pse ka lerë mangët diçka në detyrat e tij. Qortimi dhe vërejtja ka ndodh, por ka ndodhë për lehtësimin, e jo për t’ia vështirësuar gjendjen. Çështja në mes të qortimeve ka dallim shumë të madh.

VETËVRASJA

Shumica e pyesim, vetëvrasja a ç’është haram apo hallall. Ndonjëri arsyetohet: Po unë në atë rast nuk e dëmtoj askënd, dhe nuk mundoj askënd, pse është e drejtë e ime dhe jetë e ime?

Përgjigjja: vëlla i dashur zoti të udhëzoftë. O vëllai im, Allahu ta ka dhuruar jetën, e jetën tënde duhet ta lësh te ai i cili ta ka dhuruar. Për këtë arsye vrasja e tjetërkujt është njësoj në mëkat me vetëvrasjen. Sepse kjo konsiderohet shkelje e drejtës tënde. Nuk do të

thotë se një veprimi i tillë është e drejta jote. Na hadithë kudsij Zoti I Lartmadhëruar thotë: Robi im e ka mbytur veten për këtë arsye për këtë arsye ia ka ndaluar vetes xhenetin sepse ky njeri e ka pranuar jetën të cilën ia ka dhuruar Allahu atij pastaj atë jetë vet e ka shuar, e kjo nuk është e drejtë e tij.

Shkak tjetër. Vetëvrasësi, nuk e bën një gjë të tillë përpos nëse iu është vështirësuar diçka, e kjo do të thotë dobësi e imanit. Prej vlerave të imanit është me I tejkaluar fatkeqësitë dhe me imanin tënd me qen i fuqishëm ndërsa me vetëvrasje ke paragjykuar paaftësinë e Allahut ndaj tjera, e kjo nënkupton humbjen e shpresës në mëshirën e Allahut.

Duhet ta dimë se në këtë botë njeriut I ndodhin ndryshime të shumta. E tërë bota është ndryshuese. Njeriu patjetër duhet të jetë I ndërlidhur me Zotin e tij. Nëse njeriut i ndodhin fatkeqësi, ose përjeton faze kritike I kthehet Zotit të Tij. E besimi dhe lidhja me Zotin e tij i jep freski dhe force për ti tejkaluar krizat dhe vështirësitë nëpër të cilat kalon. Për këtë arsye Zoti i Lartmadhëruar thotë: Pra, me përkujtim ndaj Zotit qetësohen Zemrat. Zoti e ka fol të vërtetën. Ne, shohim se zemrat të cilat nuk e kujtojnë Allahun janë të brengosura dhe të tronditura, mirëpo atëherë kur njeriu e kujton Zotin I qetësohet zemra sepse e di se nuk I përballon vet ngjarjet dhe jo me fuqinë e tij por ballafaqohet me ngjarjet me fuqinë e Zotit të Tij dhe kjo e bën që zemra e tij të jetë e qetë.

I Dërguari I Allahut s.a.v.s. ka thënë: është interesant me besimtarin, çdo çështje që I ndodh është e dobishme, e këtë nuk e posedon askush tjetër pos besimtarit, nëse I ndodh ndonjë e mire falënderon, e kjo I sjell dobi pastaj, nëse I ndodh ndonjë e keqe, duron dhe për durimin e tij ka dobi.

I FSHEHIN TË MIRAT E BURRIT

Pyetje: Kam dëgjuar se shumica e banorëve të xhehenemit janë gra.

Përgjigje: I Dërguari I Allahut s.a.v.s. ka thënë: „Ato I fshehin të mirat e burrit” nëse I bën të mira gjithmonë dhe vetëm një here ia bën një të keqe thotë: Kurrë nuk kam pa ndonjë të mire prej teje”

Pasi që kjo është e metë e tyre, ajo e cila nuk dëshiron me qenë prej banorëve të xhenetit, le ta largojë këtë vesë, dhe kur burri t’ia bëjë në të keqe le të thotë ma ka bërë vetëm një të keqe, mirëpo gjithmonë është sjellë mire. E me këtë kënaqet dhe pajtohet burri I saj, dhe kalon jetë të lumtur me te pra mos t’ia fshehë të mirat e fiton xhenetin nëse do Zoti. Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: Çdo grua e cila vetes dhe me të është nda burri I saj I kënaqur do të hyjë në xhenet.

Lusim Allahun që ju të jeni bashkëshorte e tillë

KUJTIMI I VDEKJES

Vazhdimisht e kujtoj vdekjen, në çdo vend, në çdo moment, kur të bie të flejë e kur të zgjohem. Ky kujtim nuk më ndahet ditë e natë, dhe më ka hy në gjak. E dëgjoj zërin e tij (të vdekjes) duke më pëshpëritë në vesh zë i cili më frikëson, dhe nuk mund ta largoj, më mundon për së tepërmi, thuaja se dëshiron të më mbysë, më ka pushtuar mërzia, pikëllimi dhe dhembja, dhe jetën e shoh zi, kam mbet I pashpresë dhe nuk kam vullnet për jetë.

Përgjigja: Oj bija ime! Qetësohu, vdekja nuk është ashtu si mendon ti, nuk është përfundimi i jetës por kalim prej një faze të jetës në një faze tjetër. Oj bija ime besimi (imani) është pasaportë i kufirit të jetës së humbur, të cilën e ka përgatitë Allahu për

robërit e tij të mire, mëshira e Allahut është më e madhe se që mendon ti. Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: „Dhe mëshira ime ka përfshi gjithçka”

Ndërsa sa I përket gjendjes tënde, besoj se është për shkak të ndonjë rasti të veçantë i cili të ka ndodhur ose të ka vdekur ndonjë i afërt e i dashur befasisht dhe ai rast është shkak që ti e kujton vdekjen pandërprerë.

Prej njeriut është e kërkuar që ta kujtoj vdekjen mirëpo jo me jetuar me agoni të vdekjes. Prej mëshirës së Allahut është që ne e harrojmë ndonjëherë, sepse pot a kujtonim pandërprerë, njerëzit do të bëheshin parazit, nuk do të punonin, dhe do të ndërpritej aktiviteti jetësor.

Njeriu besimtarë le ta kujtoj vdekjen aq sa I mundëson me mbet në këtë jetë, dhe aq sa i mundëson me kaluar në botën tjetër.

AGJËRIMI ËSHTË I PLOTË EDHE PSE AGJËRUESI ËSHTË XHUNUB (I PAPASTËR)

Kur të thërret ezani I sabahut në Ramazan, unë veç kam qenë xhunub prej natës së asaj dite të ramazanit. A ndikon kjo në prishjen e agjërimit tim pasi që unë veç e kam vendos të agjëroj atë ditë.

Përgjigja: Agjërimi yt është I plotë, por ti duhet të pastrohesh (gusël) në kohën sa më të afërt me qëllim që të falësh namazin e sabahut.

MJEKU I GRAVE

Jam shtatzënë, kontrollat i kam te një gjinekolog i njohur te i cili kam besim dhe më pushon zemra, mirëpo ai nuk është i devotshëm. A konsiderohet kjo haram për mua edhe pse jam kontrolluar te një gjinekologe mirëpo tek ajo nuk kam besim se është shumë e aftë.

Përgjigje: Përderisa je e devotshme, edhe pse nuk ke besim në aftësinë e gjinekologes dhe nuk të pushon zemra te ajo, nuk ka pengesë të hulumtohet gjinekolog të specializuar i cili I frikohet Allahut, po nëse nuk hasë nuk ka kurrfarë pengese të vazhdohet te ai gjinekolog nëse nuk ka në at vend gjinekolog të specializuar pos tij.